



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 17 TETOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 17. OKTOBRA 2012. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2012**

R e n d i i d i t ë s

1. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Alma Lama, lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës

D n e v n i r e d

1. Parlamentarna debata, po zahtevu poslanice Alma Lama, u vezi potrošnje javnih fondova od strane Vlade Kosova

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Jemi në pritje të grupit parlamentar që e ka kërkuar debatin.

Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Zëvendëskryeministra,
Ministra,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Rendin e ditës e keni marrë. Kemi vetëm një pikë të rendit të ditës.

1. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Alma Lama, mbështetur edhe nga shtatë deputetë të tjerë, lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës

Debati parlamentar, me kërkesën e deputetes Alma Lama, lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës, ka qenë i radhitur në mbledhjen plenare të mbajtur më 12 tetor 2012, por në mungesë të kuorumit seanca i ka ndërprerë punimet dhe me propozim të Kryesisë është caktuar seanca ose mbledhja për sot.

E ftoj deputeten Alma Lama, në cilësinë e propozuesit të çështjes të marrë fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,
Korrupsioni mbetet problemi numër një, për sa i përket sundimit të ligjit në Kosovë. Ky fakt është konstatuar vit pas viti në raportet e progresit për Kosovën, të përgatitur nga Komisioni Evropian.

Vit pas viti situata, jo vetëm që nuk ka ardhur duke u përmirësuar, por është përkeqësuar. Praktikët korruptive janë të shprehura veçanërisht në fushën e prokurimit publik, i cili në mënyrë të vazhdueshme shpërblen kompanitë, të cilat janë të lidhura me Qeverinë.

Edhe pse Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin për financimin e partive politike, ku sanksionohet kjo logjikë korruptive, duket se kjo gjë jo vetëm nuk ka ndryshuar, por është theksuar më tej. Po kështu, është përmirësuar Ligji për prokurimin publik, mirëpo implementimi i tij po pengohet nga vetë Qeveria.

Një hulumtim i kryer nga gazeta investigative “Priport”, i dëshmuar me fakte të nxjerra nga raportet e auditorit të përgjithshëm, ka zbuluar se partia në pushtet PDK ka shpërblyer kompanitë që e kanë ndihmuar në fushatë me 100 milionë euro. Media të tjera publikojnë përditë artikuj të faktuar me tema të ngjashme. Kjo është një situatë alarmante.

“Priport” ka bërë hulumtim mbi prokurimet publike dhe ka nxjerrë se 43 nga bizneset e personat fizikë, që janë pronarë biznesesh e që në dy fushatat e fundit elektorale financuan Partinë Demokratike të Kosovës të drejtuar nga kryeministri Hashim Thaçi, kanë përfituar pra mbi 100 milionë euro tenderë publikë.

Sipas Raportit të auditimit të financave të partive për fushatën e vitit 2009 dhe atij për fushatën e vitit 2010, shuma e donacioneve që këto biznese dhanë për PDK-në është pak më shumë se 280 mijë euro. Por, nga fondet publike përfituan të gjitha së bashku mbi 350 herë më shumë. Për 11 nga këto kompani u shkel edhe ligji dhe u dëmtua buxheti për t’i shpërblyer. Këto janë konstatime të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Faktet e publikuara në gazetë do të duhej të kishin shërbyer si bazë për nisjen e hetimeve ex officio nga Prokuroria, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe madje, as pas dërgimit të lëndës nga ana e gazetarëve nuk ka filluar ndonjë hetim.

Faktet, të cilat janë bashkëngjitur në këtë kërkesë duhet të shërbejnë si një kampion alarmi, për të nisur hetimet nga ana e organeve kompetente.

Buxheti i Kosovës shfrytëzohet në kundërshtim me ligjin, me logjikë klienteliste, ndërkohë që qytetarët e Kosovës vazhdojnë të jetojnë në varfëri të thellë.

Ja disa fakte të shpejta të nxjerra nga Raporti i UNDP-së, që përshkruajnë gjendjen aktuale të varfërisë në Kosovë:

- Rreth 16,7% e popullatës së Kosovës vlerësohet se jeton në varfëri ekstreme, me më pak se 1 euro në ditë, për nevojat bazike të ushqyerjes.
- Rreth 45%, pra 2 nga pesë veta konsiderohet i varfër. Këto janë individë, të cilët jetojnë me më pak se 43 euro në muaj.
- Varfëria është më e shprehur në zonat rurale. Rreth 15.5% e fëmijëve dhe 23% e grave shtatzëna vuajnë nga anemia, për shkak të kequshqyerjes.

Këto shifra të varfërisë janë alarmante, por kjo gjendje e rëndë nuk trajtohet me seriozitet nga ana e Qeverisë, për më tepër abuzohet me paratë publike. Kjo mënyrë e përdorimit të tenderëve publikë për financimin e fushatës nga ana e një partie politike, ka edhe dy pasoja të tjera të rënda.

Së pari, krijon pabarazi mes të subjekteve politike dhe në këtë mënyrë një parti e blenë pushtetin me paratë e taksapaguesve. Dhe së dyti, duke qenë se në tenderë publikë mund të konkurrojnë edhe kompani të huaja, rrezikohet komprometimi i pushtetit nga këto kompani dhe futja e kapitalit të huaj për qëllim të blerjes së pushtetit dhe rrjedhimisht edhe vetë shtetit.

Kuvendi i Kosovës, si organ mbikëqyrës i punës së Qeverisë, ka përgjegjësi të madhe dhe duhet ta luajë rolin, për të cilin është mandatuar, duke llogari nga ekzekutivi për mënyrën

e shpenzimit të parasë publike. Prandaj, ne kërkojmë që të debatohet në lidhje me këtë çështje.

Kuvendi është forumi, ku do të duhej të dilnin të vërtetat dhe në rast se këto të vërteta, të cilat janë botuar në media, nuk kanë qenë të tilla, është dashur të përgënjeshtrohen. Unë po pres argumentet nga të gjitha palët, në lidhje me këtë situatë tepër skandaloze, sa i përket prokurimit publik. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Qeveria nuk dëshirojnë të marrin fjalën. Atëherë, shkojmë sipas grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne si grup parlamentar, parimisht jemi mbështetës të çdo debati, që është në interes të qytetarëve dhe që i kontribuon rendit dhe ligjit të vendit tonë, në veçanti, administrimit sa më të mirë të financave publike.

Shpenzimi i parasë publike është i rregulluar me kornizën ligjore, e cila i përcakton qartë mandatin dhe përgjegjësitë e organizatave buxhetore, në menaxhimin e fondeve publike.

Gjithashtu, në Kosovë janë të krijuara edhe institucionet dhe mekanizmat e kontrollit të rregullt të shpenzimeve publike, sikurse janë: auditimi i brendshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Ministria e Financave, bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, rregullisht paraqet në baza periodike - Raportin financiar të buxhetit të Republikës së Kosovës. Raporte të tilla, përveçse diskutohen dhe miratohen në institucione, përfshirë edhe Kuvendin, ato bëhen publike në ueb-sajtin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Po ashtu, Qeveria ka përgatitur dhe aprovuar edhe dokumentin e politikave të kontrollit të brendshëm të financave publike dhe procedurave për menaxhimin financiar dhe kontroll.

Menaxherët e të gjitha niveleve të institucioneve publike, duke përfshirë si të hyra publike ashtu edhe aspektin e shpenzimeve, duhet të jenë përgjegjës për detyrat, që ata i krijojnë jo vetëm politikat operationale, por edhe politikat e menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Që të përmbushen standardet e theksuara më lartë, Qeveria e Republikës së Kosovës, e ndihmuar nga Bashkimi Evropian, ka hartuar dhe miratuar dokumentet si në vijim:

- Dokumentin e politikave të kontrollit të brendshëm të financave publike,
- Rregullën financiare 01,
- Menaxhimi financiar dhe kontrolli, dhe

- Doracakun e procedurave për menaxhimin e financave dhe kontrollit.

Në këtë drejtim, rregullisht paraqitet edhe Raporti për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës.

Për të vënë në praktikë një qeverisje sa më të mirë, në këtë drejtim është krijuar korniza operative, dokumenti i politikave mbi kontrollin e brendshëm financiar, me të cilin përcaktohen përgjegjësitë dhe procedurat që duhet zbatuar.

Autidimi i brendshëm, si pjesë e kontrollit të brendshëm financiar po luan rolin e tij kyç, duke ofruar ndihmë për efikasitetin dhe efektivitetin e vazhdueshëm të kontrollit të brendshëm dhe duke rekomanduar për përmirësimet dhe avancimet e duhura.

Në raport, raportet e auditorit për fushatat zgjedhore, për zgjedhjet lokale 2009 dhe për zgjedhjet qendrore 2010, janë vlerësuar si shembull që kemi deklaruar të gjitha shpenzimet e ndara edhe për degë. Janë raportet e auditorit për 2009 dhe 2010 ato që na dëshmojnë, se në detaje kemi pasqyruar listën e donatorëve, të gjitha të hyrat që kanë qenë konform kuadrit ligjor.

PDK, si subjekt më i madh politik ka qenë maksimalisht i impenjuar, që të jetë sa më transparent rreth financimit dhe marrjes së donacioneve nga subjektet e ndryshme. PDK, gjatë gjithë kohës ka respektuar nenin 5, të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-174, për financimin e subjekteve politike. Donacionet e personave fizikë dhe juridikë për PDK-në kanë qenë transparente, janë bërë përmes llogarive bankare dhe kanë qenë të pasqyruara, të përfshira në raportet financiare të PDK-së.

Në funksion të transparencës PDK ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me auditorët e angazhuar nga KQZ, si institucion i pavarur për t'i mbikëqyrur financat e partive politike dhe shpenzimet publike.

Të nderuar deputetë, të gjithë jemi të interesuar që shfrytëzimi i parasë publike të jetë sa më racional dhe i drejtë, andaj debati i thirrur sot është shumë tendencioz dhe i pamenduar mirë. E them këtë, sepse nuk ka për qëllim që të pasqyrohet drejtë shpenzimi i parasë publike, por vetëm që po e shfaq tendencën për t'u munduar të atakojë kompani publike, të cilat janë taksapagues të pagave tona dhe punëdhënës të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ndërsa, si shembull, nuk dëshiroj t'ua kujtoj se disa nga firmat e drejtuesve të Lëvizjes "Vetëvendosje", apo familjarëve të tyre, kanë qenë fitues të shumë projekteve që kapin shifra milionë eurosh.

Por, sikur të ishte ashtu siç pretendon kërkuesi i debatit, firmat private që për pronarë kanë deputetë dhe udhëheqës të Lëvizjes "Vetëvendosje", nuk do të arrinin të merrnin asnjëherë tenderë nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Parashtruesja e debatit është dashur të pyes paraprakisht Lëvizjen nga vjen, se sa deputetë të saj marrin punë direkt apo indirekt nga buxheti publik i kësaj Qeverie. Të gjitha këto kompani, edhe pse janë financues të gjitha partive, marrin punë nga Qeveria e sotme. Kjo është dëshmi e fuqishme se Qeveria e Kosovës, nën udhëheqjen e kryeministrit Thaçi, nuk i ka përzgjedhur kurrë kompanitë politikisht, sepse në të kundërtën këto kompani nuk do të kishin marrë asnjë punë.

Kjo dëshmon, që Qeveria Thaçi ka respektuar fuqimisht procedurat ligjore, gjithnjë duke mos i parë taksapaguesit kosovarë me orientim politik, siç pretendohet këtu.

Pra, ju zonja Lama dhe kolegë të Lëvizjes “Vetëvendosje” po mundoheni, që me nisma të tilla, në Parlamentin e Kosovës, të paraqiteni me fytyrë engjëlli, por Kosova është e vogël dhe secili e njeh njëri-tjetrin. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritës kryetarin, Kabinetin qeveritar,

Kolegë të nderuar deputetë,

Mendoj se parashtrimi i një nocioni të kësaj natyre, është i arsyeshëm dhe është shumë normal që të ndodhë, është e shëndetshme për vetë Qeverinë e Kosovës.

E them këtë në start, se sikur u paragjykua nga parafolësi - pse është kërkuar? Unë mendoj, se debate të tilla janë të shëndetshme, në radhë të parë për Qeverinë e mandej për Kosovën.

Në rrethanat, në të cilat punojmë, vërehet se ka shumëçka që ngel për t'u dëshiruar. Do t'i referohem disa fakteve, përmes të cilave kemi kaluar si Komision për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ku në shumicën e rasteve kanë qenë të dy parafolësit e mi dhe janë të njohur me të gjitha ato të gjetura dhe pasqyra të prezantuara.

Kosova ka një progres në paraqitjen e formës së prezantimit të pasqyrave financiare, por ajo është veç një auditim i formës se si janë prezantuar tabelat, por jo edhe brendinë e tij, jo edhe performansën e tij. Të tilla nuk kemi dhe aty ngelë. Unë e kam ngritur këtë çështje shumë herë edhe këtu në Kuvend, që Zyra e Auditorit ka për detyrë dhe ne duhet ta detyrojmë atë, që sa më shpejt të ketë staf profesional në trajtimin e performancës së institucioneve. Të bëjmë koston e investimeve të investuara në kthim të shërbimeve apo të mirave, që i përfitojmë për ato para.

Nëse i bëjmë një vështrim, ta zëmë vitin e kaluar, ku rreth 40 raporte të auditimit i kemi shqyrtuar. Vetëm në një rast kemi gjetur që janë respektuar rregullat e trajtimit të pasurisë që disponon. Vetëm një rast e kemi gjetur që nuk ka pasur shkelje, në të gjitha rastet tjera ka pasur shkelje, mos regjistrimi. Evidenca është, në disa raste ne e kemi diskutuar edhe rastin e RTK-së edhe të disa bordeve edhe të disa ministrive. Është gjendje alarmante edhe pse e hesht këtë Thesari, pse nuk merr material, gjegjësisht pse nuk ngre trajtim,

nëse i duhet, shtesë, e unë mendoj, se ligji disponues është i mjaftueshëm, por ai nuk po zbatohet.

Po t'i referohemi Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe Ligjit mbi prokurimin, tre muajt e fundit të vitit kalendarik janë vite, që kanë reduktime drastike në përdorimin e fondeve për investime.

Nëse e shikojmë, javën e kaluar, raportin e fundit që e shqyrtuam, del se brenda dy muajve është shfrytëzuar buxheti kapital në një subjekt 58%. Atëherë, kemi të bëjmë me shkelje të ligjit edhe të njërit edhe të tjetrit. Po t'i referohemi prokurimit publik, meqë u ngrit si temë, nuk e kemi asnjë raport të shqyrtuar, që nuk ka vërejtje në shkelje të procedurave, deri në raste që kanë nevojë për hulumtim të mëtutjeshëm.

Po ashtu, javën e kaluar, raportin e fundit kur e shqyrtuam pamë se në Universitet ka rast që është ngritur padi konkrete dhe fle ajo padi dy vjet në Prokurorinë Publike. E ka ngritur menaxhmenti, s'e ka ngritur as Zyra e Auditorit, as ne, po e ka ngritur menaxhmenti i Universitetit. Pse nuk përcillet kjo, pse nuk ndodh?

E kemi thënë shumë herë, që një çështje nëse diskutohet dhe nuk ndërmerret veprim, ai e stimulon atë proces.

Unë mendoj se ka shumëçka për t'u dëshiruar. Ka shumëçka që duhet të rregullohet në start. Ka edhe keqpërdorime, por unë nuk jam kompetent tash ta them se ka keqpërdorim. Ne themi se dyshojmë dhe kërkojmë që ai të hulumtohet, të investigohet më tutje, ato nuk ndodhin. Auditorit na thotë se ka ngritur shumë çështje, për të cilat ka kërkuar trajtim specifik të çështjes së caktuar, po ato i ka çuar në EULEX, jo edhe në institucione tona. Ngelin, informacione nuk kemi. Po t'i referohemi, po them, auditimit të brendshëm, njësitë që kanë auditim të brendshëm dhe komitet të auditimit dhe i kanë trajtuar dhe u kanë dhënë hapësirë trajtimit në mënyrë profesionale, të gjeturat janë shumë më të vogla.

Është shqetësuese një çështje tjetër, që mua më dhemb dhe e paralajmëroj për një rrezik Qeverinë, në këtë drejtim. Në vitin 2009, ta zëmë, ka pasur 3 milionë bartje të obligimeve prej vitit në vit, në vitin 2010 shkon 18, në vitin 2011 i ka 39 pikë diçka afër 40 milionë i ka obligime të vitit paraprak. Shtrohet pyetja si? Lidhen kontrata pa zotim të mjeteve, vazhdoen kontrata pa procedura. Kemi raste, në të shumtën e rasteve, kemi shumë raste, se jo në të shumtën e rasteve, po kemi shumë raste, kur favorizohet kontraktuesi me çmim më të shtrenjtë karshi të lirit. Ngritët ajo çështje, se nuk duhet të jetë më i liri më i miri, por në dinamikën që jep, ta zëmë në Ministrinë e Arsimit e kemi rastin e ngritjes së 23 shkollave. Në vitin 2009 janë kontraktuar. Ato shkolla ende janë të papërfunduara. Nuk ka para, ka ngecur. Për këto, sigurisht se do të ketë ndëshkime, padi gjyqësore dhe ekzekutim gjyqësor, do t'ia çrregullojë raportet.

Kjo është pasoja e atyre, që hyhet në obligime pa zotime dhe kjo është frika, që unë mendoj se po të ngritët kjo temë dhe të trajtohet në mënyrë profesionale, ne do ta kemi një gjendje tjetër.

Unë kam edhe një brengë tjetër, raportet të cilat jo vetëm Komisioni që iu ka dërguar, ka disa, janë pak në numër, por megjithatë duhet të jemi preventiv, që raportet kthyesë, përkatësisht planin e veprimit që duhet ta kthejë, nuk e kanë kthyer. Merreni Radiotelevizionin e Kosovës, dy herë kemi marrë vendim, ne ende nuk e dimë. Pasuria, e kam ngritur, këtu është e trajtuar, regjistrohet në emër të drejtorit gjeneral gjithçka që ka atje, duke filluar prej ndërtesës deri tek mikrofoni. Kjo është në kundërshtim me çdo akt normativ, kjo është në kundërshtim me logjikën, sepse ai nuk mund ta përcjellë.

Thotë - ligji shkelet dhe nuk zbatohet, kjo është një brengë. Legjislacioni është i mirë. Unë nuk kam vërejtur, që ka legjislacion që e pengon këtë procedurë ose respektimi i tij na sjellë në situata të pakëndshme. Për bindjen time dhe të Komisionit është, se ligji është i mirë, por ligji nuk po zbatohet. Rol kyç duhet të luajë këtu Thesari, i cili është dërrasa e fundit ku lëshohen mjetet. E ngrita atë, 58% dy muajt e fundit, s'ka të drejtë, s'ka asnjë përgjegjësi në këtë drejtim. Dhe, mos llogaridhënia sikur po e trashë këtë bindje dhe po vazhdohet me avazin e vjetër.

Unë mendoj, se nocioni mirë është ngritur dhe diçka të tillë është mirë shpesh të kemi dhe të diskutojmë, pa tendenca të politizimeve të skajshme, siç e pamë rastin, jo biznesmeni i këtij ose i atij. Ne jemi Kuvend dhe duhet ta ruajmë dinjitetin e Kuvendit. Vijnë prej strukturave politike, por megjithatë jemi të një Kuvendi dhe të një teme, të një interesi. E shoh tepër diletante mënyrën ekstreme të mbrojtjes të çështjeve, që ndodhin nganjëherë, mbrohet jo ky biznes, jo ai biznes. Mund të flasim me emra konkretë atëherë, kur janë favorizuar? Unë fola raste konkrete, raste konkrete që kanë nevojë për hulumtim, raste nevojë është ngritur padia - fle. Ka edhe shumë raste të tjera, që janë ngritur, por nuk ekzekutohen deri në fund. Në pushtetin lokal, kemi shumëçka abuzime edhe në prona, në prokurim, në prona dhe në mosrespektimin e proceseve të auditimit të brendshëm.

Pronën publike, në shumë komuna e trajtojnë si diçka personale të kryetarit. Ka raste të trajtimit të pronës edhe pa vendim të asamblesë. Çka flet kjo? Do të thotë, është koha e fundit që auditorit t'i japim edhe më tutje përkrahje, ta favorizojmë dhe debatet që diskutojmë dhe bashkërisht konstatojmë se ka shkelje, në veçanti te institucionet e pavarura, është koha e fundit, zoti kryetar, që dikush t'i thotë stop. Nëse një herë dikush ka bërë shkelje, herën e dytë, raporti i parë e i dytë, figurojnë shkelje, me të njëjtin menaxhmenti, unë nuk e di çka pret ai menaxhment. Këto dukuri i kemi. Dhe, unë mendoj se Kuvendi në veçanti, pos Qeverinë që duhet ta mbajmë përgjegjëse, sepse ajo është ekzekutore, ne i kemi edhe këto njësitë e pavarura që ne jemi direkt të lidhur me ta dhe ata duhet pak më afër t'i mbajmë, në mënyrë që proceset dhe detyrat të kryhen në harmoni me dispozita dhe besimin që është ngarkuar. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të "Vetëvendosjes", a e do dikush fjalën? Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Dua ta filloj këtë fjalë timen në këtë temë me diçka, që në shikim të parë nuk duket e lidhur, por në fund do ta kuptoni që është e lidhur.

Sot është nënshkruar kontrata, pra para gjysmë ore, për privatizimin e rrjetit të Distribucionit të KEK-ut, me të cilën Qeveria e Kosovës po thotë, që do t'i fitojë 26.3 milion euro, por asnjëherë s'na ka treguar se çka po jep për këto 26.3% milion euro.

Pra, është çështje që lidhet drejtpërsëdrejti me temën që po flasim e që është korrupsioni dhe zhvleftësimi i qëllimshëm i ndërmarrjeve publike, për t'i shitur ato. Prandaj, është tema, e ju deputetët e PDK-së që po e sillni kryet, ndoshta edhe s'e kuptoni e ndoshta edhe po ju dhemb, po tema është kjo.

E dyta, sot deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë ndaluar nga Policia e Republikës së Kosovës, me urdhër të ministrit të Rendit, i cili ishte këtu e tash nuk është, për të hyrë në objektin qeveritar dhe policia dhunshëm na ka nxjerrë neve jashtë nga oborri qeveritar dhe na e ka mbyllur edhe derën e hyrjes në Kuvend, prandaj jemi vonuar sot në këtë seancë, për shkak se policia na thanë, që kemi urdhër të mos ju lëmë të hyni. Në kundërshtim me ligjin, i cili thotë që deputeti ka të drejtë të hyjë në objekte qeveritare, kur të dojë dhe si të dojë, duke treguar natyrisht, kartën e identifikimit të deputetit. Pra, këto janë dy gjëra, që lidhen me temën, për shkak se janë dy gjëra, me të cilat mbrohet dhunshëm korrupsioni për të cilin po flasim.

Herën e kaluar, kur u ndërpre seanca, një prej arsyetimeve dhe një prej kërkesave të Grupit Parlamentar të PDK-së, përmes kryetarit të tyre, ishte që të vazhdohet debati deri në fund. Tha: ne jemi të gatshëm të debatojmë për këtë çështje, madje-madje i quajti këto akuza. Pra, tha që kërkesa jonë për debat është akuzë.

Dhe, unë po ju them edhe juve, pra të gjithëve, që po, vërtet është akuzë. Po të kishim pasur shtet të së drejtës këtu, po të kishim pasur gjyqësor të pavarur dhe profesionistë, natyrisht që ky debat dhe ky raport i organizatës "Çohu", që e kam këtu e që sigurisht, po besoj që e keni lexuar edhe ju deputetë të PDK-së, do të shndërrohej në akuzë shumë lehtë. Por, meqenëse nuk kemi gjyqësor të pavarur, atëherë natyrisht që duhet ta debatojmë këtë çështje në Kuvend, për shkak se gjyqësori nuk po prodhon, sepse faktet për të cilat po flasim këtu, janë fakte të cilat nuk kanë ndodhur dje, janë duke ndodhur prejse është kjo Qeveri në pushtet. Pra, janë duke ndodhur që tash pesë vite, prandaj deri tash gjyqësori do të ishte dashur të ndërhyjë, por nuk po ndërhy. Dhe, ne të gjithë e dimë pse nuk po ndërhy, se gjyqësori në fakt janë këta, ja këta këtu.

Dhe, pastaj është hera e dytë, që Qeveria prapë refuzon të merr pjesë në këtë debat. Nuk po flas për juve ministrave që jeni këtu, ne e kemi bërë shumë të qartë atë ditë, që të rëndësishëm për këtë temë, meqenëse po flasim për shpërdorimin e parasë publike, janë: kryeministri, ministri i Financave dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, jo ju. Juve ju kanë pru të vini këtu veç sa për të thënë që kemi qenë. Pra, ju në këtë rast jeni do farë kukullash, që e përmbushni fytyrën e Qeverisë, ku mungon Qeveria e vërtetë për temën për të cilën po flasim.

Dhe, çka bën Qeveria, na e dërgon Grupin Parlamentar të PDK-së për të shpifur këtu, i cili në këtë rast e përdori deputetin Ramiz Lladrovci.

Ne, pra i paraqitëm faktet dhe është një hulumtim, që nuk e ka bërë Lëvizja “Vetëvendosje”, po e ka bërë një organizatë e shoqërisë civile, e cila edhe kur e ka publikuar këtë raport e ka lutur Qeverinë dhe të gjithë ata që përmendëm këtu, që të përgënjeshtrohet. Pra, ka thënë ju lutemi na përgënjeshtrojeni, ju lutemi na tregoni që nuk paskemi të drejtë, po nuk ka pasur kësi përgënjeshtrimi. Po, kjo tregon që këto janë të drejta, këto janë të vërteta. Dhe, pastaj Ramiz Lladrovci thotë: ne e dimë për Vetëvendosjen. Mirë, Ramiz, ti po ditke për Vetëvendosjen, ju i keni 40 deputetë apo jo, të koalicionit. Kur të duash, çfarë të duash teme për “Vetëvendosjen” thirre edhe e debatojmë në Kuvend. Kur të duash, e ke mundësitë, i ke nënshkrimet, për cilin të duash deputet të Lëvizjes Vetëvendosje debatojmë, por sot po flasim për shpërdorimin e mjeteve publike, që i bën Qeveria e Kosovës. Pra, qëndroni temës. Kur të duash, prapë po them, nëse do të debatosh për Lëvizjen “Vetëvendosje”, ne jemi të hapur.

Dhe, kryeministri, natyrisht e injoron këtë debat. Po a e dini pse e injoron kryeministri? Nuk është se vetëm ai është përgjegjës drejtpërsëdrejti për financa publike, gjë që dihet botërisht, po ai e injoron këtë debat edhe për një arsye tjetër, për shkak se në këto përfitimet kryesore, që i kanë pasur kompanitë, i kanë pasur nga Korporata Energjetike e Kosovës. A e dini ju kush ka qenë shef i prokurimit në Korporatën Energjetike të Kosovës? Nijazi Thaçi. A e dini pse e ka mbiemrin Thaçi, se është kushëri i kryeministrit Thaçi, prandaj e ka mbiemrin Thaçi. Pra, nuk është ai një njeri që është aty dhe që ka qenë shef i prokurimit për shkak të profesionalizmit, nuk është se e ka diplomën, por sepse e ka letërnjoftimin me mbiemrin Thaçi. Kaq i është dashur atij. Kryeministri e ka vendosur në atë pozitë dhe përmes tij pastaj e ka bërë këtë shpërdorim të kompanisë publike, për shkak se sa më larg rrethi i korrupsionit, aq më i qetë kryeministri. Pra, thotë nuk po e bëj unë, po e bën Nijazi Thaçi me KEK-un. Po ngadalë bre, kush është Nijazi Thaçi? Nijazi Thaçi, kushëri i tij, pra. Dhe, natyrisht po i shoh do reagime këtu te PDK-ja. Ju lutem na kallëzoni sa të afërt janë, se unë nuk e di bash saktësisht, por ju sigurisht se e dini.

Çështje tjetër, KEK-u është kompani publike, e cila së bashku me PTK-në janë dy prej kompanive, të cilat më së shumti janë dëmtuar prej vitit 1999 dhe këto dëmtime kanë qenë të qëllimshme. Pra, siç i ka ndodhur Postës dhe Telekomit të Kosovës, me intervenim të drejtpërdrejtë të politikës nga lartë përmes bordeve dhe nga poshtë përmes agjentëve, që i kanë futur aty si të punësuar, ashtu i ka ndodhur edhe KEK-ut. Por, këtu po e shohim në këtë raport të “ÇOHU”, që KEK-ut në fakt i ka ndodhur edhe përmes zhvatjes së qëllimshme, të drejtpërdrejtë dhe publike të fondeve të tyre, për kompani të caktuara, të cilat formalisht i publikojnë nga 700-800 euro, që i kanë dhënë donacione Partisë Demokratike të Kosovës, ndërkohë që realisht ne të gjithë e dimë se i kanë dhënë shumë më shumë.

Pra, kur flitet për transparencën e financave publike, jo të kompanive por të partive politike, të dini ju që prej krejt vëzhguesve të kësaj skeme demokratike të kësaj skeme demokratike, që po e quajmë, në Kosovë, Partia Demokratike e Kosovës, vlerësohet më

së poshtmi. Asnjë raport financiar ju nuk e keni pasur siç duhet, kështu që le të dihet kjo, domethënë, që ju nuk i tregoni financat. Ndoshta gaboni në raportim, ndoshta nuk e keni aftësinë kontabiliste për të raportuar siç duhet, por ndoshta edhe fshihni, e mua po ma merr mendje që fshihni.

Te energjia, te sektori i energjisë, Ballkani është nën thundrën e një mafie të organizuar energjetike, e cila kontrollohet prej kompanive serbe dhe krejt energjinë elektrike, të cilën e kemi blerë ne si Kosovë, të cilën e kemi importuar prej këtyre kompanive, që është kompania Rudnap, që është kompania tjetër, që s'po më kujtohet tash emri, po që sigurisht ju e dini më mirë se unë e të cilat disa janë të regjistruara në Beograd, disa në Zvicër, disa në Londër, po të gjitha janë në pronësi të serbëve nga Serbia. Dhe, këto janë drejtpërsëdrejti të lidhura jo vetëm me mafinë serbe, po edhe me politikën serbe. Pra, kjo lidhje kaq e çuditshme mes mafisë serbe dhe në mënyrë indirekte mes politikës në Kosovë dhe politikës në Serbi, po e dëmton Kosovën, për shkak se po ia shkatërron kapacitetet energjetike Kosovës, po i shkatërron ndërmarrjet publike të Kosovës dhe po ia shkatërron mundësinë që Kosova të bëhet e pavarur në sektorin energjetik.

Pra, kjo mafi në interesin e saj e ka që ta mbajë Kosovën pjesë përbërëse të rrjetit energjetik të Serbisë dhe këtë qëllim edhe dëshirë të kësaj mafie, po ia plotëson edhe Qeveria në Prishtinë, po dorën në zemër edhe Qeveria në Tiranë. Prandaj, të gjithë e dimë madje edhe me emra, se kush janë këta persona, të cilët kanë filluar të shërbejnë si sekserë të energjisë elektrike, pastaj kanë filluar të shërbejnë si sekserë edhe në sektorë tjerë, e në fund e pamë që na i zgjedhin edhe presidentët, me SMS-a me zarfa dhe me të tjerat. Pra, jemi duke folur për një mafi shumë mirë të organizuar, që është krim i organizuar e cili është instaluar në qarqet më të larta të Qeverisë së Kosovës. Po, pikërisht të atyre që sot kanë shkuar të pinë verë, mbasi që e kanë shitur edhe një kompani të Kosovës e që nuk kanë ardhur këtu që të na tregojnë, nëse këto fakte, për të cilat ne po flasim janë të vërteta apo vërtetë, “Çohu” paska shpifur e këta paskan të drejtë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Mendoj se tema, për të cilën sot po debatojmë është goxha e gjerë, kemi pasur diskutime shumë herë, po asnjëherë të strukturuar. Mendoj se sot kemi gjasë që të kemi debat të strukturuar, përpos deklaramit të fakteve, të cilat janë të pamohueshme.

Mendoj, se fakti që ka pasur abuzim serioz me buxhetin e shtetit, prej nivelit komunal deri në nivelin e përgjithshëm, është i pamohueshëm. Mendoj, se kushdo që provon ta mohojë se është abuzuar me buxhet, i bënë dy dëme. Fillimisht, e fsheh atë që ka ndodhur edhe pjesën e dytë e dëmton tehun e shoqërisë kosovare që të mbërrijë me u marrë me këtë problem.

Disa herë kam thënë, edhe zogjtë e dinë që buxheti është vjedhur. Po, ky është aspekti i parë dhe sot, në emër të grupit të Aleancës nuk e kem në plan të ndalem aq shumë në

detaje, të cilat i kemi përmendur, do ta përmend ndonjë, vetëm sa për kujtim, është aspekti i dytë i menaxhimit të parasë publike ose menaxhimit të gabueshëm i parasë publike. Abuzimi është nën një, por nën dy është planifikimi i gabueshëm i shpenzimit të mjeteve dhe ky është një problem i madh. Vetëm t'ju përmend, shembull të marrim një shembull i cili e ilustron, se çka është planifikimi i gabueshëm dhe antizhvillimit afatgjatë të vendit, janë shpenzimet në rrugë. Për tri vjet Qeveria e Kosovës, Qeveria e kaluar, ka shpenzuar qindra milionë në rrugë, duke punuar me kompani vendore dhe përnjëherë i ka ndërprerë ato shpenzime dhe ka filluar të punojë me autostradën me kompani të huaja. Kjo ka bërë, që të gjitha kompanitë vendore ose shumica dërmuese e tyre, të cilat kanë përfutur prej buxhetit të Kosovës, në mënyra të ndryshme, nuk po ndalem tash aty, dhe të cilat kanë investuar në makineri dhe në kapacitete, për një moment janë ballafaquar me bankrotin. Ky është planifikimi totalisht i gabueshëm për zhvillim afatgjatë. Domethënë, është shpenzuar shumë për një afat të shkurtë dhe është ndërprerë shpenzimi, ky është gabim!

Janë ndërtuar shkolla, e tash shihet që i kanë nga 3 ose 4 nxënës ose fare. Janë shpenzuar mjetet, me një qëllim të mirë, krejt në rregull. Duhet të ndërtojmë shkolla, ama nuk ka pasur proces të menduarit, nuk ka pasur proces, i cili do të sillte vendime normale me efekt pozitiv afatgjatë, jo vetëm me efekt pozitiv dy-tre mujor, katër mujor ose për propagandë.

Dhe, rasti i tretë është kur edhe abuzimi edhe planifikimi i gabueshëm kanë qenë bashkë, të dyja bashkë kanë ndodhur. Mos e harroni Abetaren, ju kam përmendur në këtë Kuvend të Kosovës, i ka kushtuar 15 euro një buxhetit të Kosovës, ose arkat fiskale, që nuk janë drejtpërdrejt shpenzim i buxhetit, mirëpo kanë sjellë një disbalancë totale në shoqëri dhe e kanë ulur buxhetin, se tani me një pompozitet kanë hy, me çmime enorme dhe gjysma e bizneseve i kanë, gjysma e bizneseve nuk i kanë dhe kurrkush s'merret me këtë punë. Domethënë, ata të ndershmit janë dënuar dhe ata që kanë abuzuar vazhdojnë të punojnë.

Mendoj se të gjitha këto që i përmenda dhe prapë nuk po dua të lëshohem tepër në detaje, tregojnë se në Kosovë duhet pasur mendim të strukturuar për të luftuar korrupsionin dhe abuzimin me buxhet. Janë dy mënyra. Mënyra e parë për me e ndalë këtë kleptokraci, po ju them, prej nivelit lokal deri në nivelin qendror, edhe një herë po dua ta përsëris, ta vë theksin, kushdo prej nesh që provon t'i mohojë është duke bërë dy mëkate kundër vendit. Mënyra e parë është të provohet të bëhet me revolucion, për ta ndalur, për ta kthyer përmbys sistemin. Po, po ju kallëzoj diçka, historia e njerëzimit nuk njeh rast, në të cilin me revolucion është ndalur korrupsioni. Ka ndodhur e kundërta, para revolucionit është vjedhë aty-këtu nga pak me tenderë, mbas revolucionit është vjedhur krejt përnjëherë dhe s'ka pasur kush kënd ta akuzojë. Kjo është një mënyrë.

Mënyra tjetër është të mendojë secili prej nesh, çka duhet bërë strukturalist dhe kulturalisht në këtë vend tonin të dashur, që për një afat të caktuar kohor, të paktën ta kemi në kontroll, se sot korrupsioni dhe abuzimi me buxhet është jashtë kontrollit. Dhe po dua ta vë theksin, jo vetëm në nivel qendror, por edhe në nivel komunal, është jashtë kontrollit me toka me buxhet, me licenca, me gjithçka.

Zhvillimi afatgjatë është balancim ose lufta afatgjatë është balancim. Balancim në mes, domethënë të punës strukturale, cilat janë ligjet, cilat janë metodat që i përdorim, cilat i kemi gjyqet. Qysh i mbron politika gjyqet? A i mbron duke i këqyrur edhe duke i frikësuar, apo i mbron prej atyre që i sulmojnë? Çka bën politika e Kosovës? Deri më sot pretendon se po i mbron, është i këqyrur drejt në sy edhe duke i frikësuar edhe me tepër, duke i shtirë nën thundër të politikës. Ky balancim nënkupton se duhet ngritur pragu i dhembjes në shoqërinë kosovare për abuzim.

Arsyeja pse ndodh kështu, nuk domethënë që dikush është i keq, se mbani mend një fjalë, po e bëj një xhep në këtë bisedë timen. Kjo Qeveri ka ardhur në pushtet duke e akuzuar Qeverinë paraprake se është e korruptuar. Kjo Qeveri vazhdimisht ka thënë që këta janë të korruptuar dhe në momentin, që ne vijmë në pushtet ne do ta zhdukim korrupsionin. Ka ndodhur e kundërta. Po, nuk guxojmë të lejojmë që vazhdimisht të ndodhë e kundërta, që kushdo që të vijë në pushtet, do të vijë në pushtet me gojën plotë luftë kundër korrupsionit dhe në momentin, që të vijë në pushtet do të ballafaqohet me vetveten, se nuk po mbërrim ta rrisim prapun e dhembjes. E ky pragu i dhembjes, po ju tregoj shumë popullorçe çka është. Nëse në një vend të perëndimit, e gjysma këtu e keni ose më tepër, nga një kushëri ose keni qenë vetë, dikush e hedh një karrocë me mbeturina afër rrugës, komuniteti reagon shumë, se për ata kjo është një shkelje tepër e rëndë dhe nuk ka si të mos merret sistemi politik me atë punë, se reagimi është tepër i madh. Në vendin tonë, na vijnë miq, kushërinj, shokë, të cilët kanë abuzuar jashtëzakonisht shumë, me kiamet shuma të mëdha të mjeteve dhe reagimi i publikut nuk është qysh duhet të jetë. Tash çka të bëjmë ne? A duhet ta ndërrojmë publikun? Nuk mundemi, se ne jemi pjesë e publikut. Apo duhet ta lëmë publikun të na ndërrojë neve? Prapë është e njëjta gjë.

Mendoj se ky është ai balancimi për të cilin po flas, duhet të rritet pragu i dhembjes, jo vetëm i yni në Kuvend, por i krejt shoqërisë kosovare. Po, kush e udhëheq këtë rritje të pragut të dhembjes? Nuk mund të presim prej njerëzve, se atëherë na ndodh ai revolucion. Duhet ta rrisim ne, duke shkuar e duke e zvogëluar e duke dhënë shembuj personal. Mendoj se kanë munguar në masën më të madhe të mundshme.

Dua t' ju jap disa shembuj para se të përfundoj dhe t' ju tregoj se çka mendon Aleanca, për t' ju treguar se çka domethënë shoqëria kleptokratike. Unë kam qenë ministër për tri vjet. Ka pasur rast kur kanë ardhur te unë medime, jo një po më shumë, jo të gjitha, të jemi të saktë edhe eksplicit më kanë thënë në fytyrë, nëse na i jep reklamat nuk të shajmë. Nëse do të më sfidojnë, ju tregoj edhe cilat janë. Ka pasur elemente të shoqërisë civile, të cilat kanë ardhur dhe kanë kërkuar donacione, jo të gjitha prapë, të jemi korrekt, ka pasur institucione korrekte në shoqërinë civile edhe media korrekte, por po dua t' ju them që ky sistem kleptokartik nuk mund të zhduket nëse ne veç do të themi: hiqni këta të këqijtë se vijmë ne të mirët dhe ta bëjmë një punë të keqe. Kjo nuk e amnistion Qeverinë për këto pesë vjetët e kaluara. Mendoj se kjo Qeveri për pesë vjetët e kaluara e ka shndërruar korrupsionin në sistem dhe ka ardhur te një element, që thonë anglisht overwhelming, nuk po dimë me çka të merremi më përpara dhe kjo duhet ndërruar.

Aleanca mendon se pa u dënuar njerëzit që kanë vjedhur, nuk kemi gjasa as teorike, për ta luftuar korrupsionin afatgjatë. Nëse vetëm edhe një njeri, që dëshmohej se e ka

dëmtuar buxhetin ose ka abuzuar me pushtetin, nuk dënohet, vetëm një nuk dënohet, krejt tjerët lirisht duhet t'i lëshojmë që të shkojnë në shtëpi. Secili njeri që dëshmohet, që ka vjedhur, duhet të shkojë në burg, zonja dhe zotërinj deputetë dhe kjo është alfa e krejt luftës kundër korrupsionit.

Pjesa tjetër, fola për gjyqet, fola për njerëzit, pjesa tjetër është të kemi sistem të menduarit në Kosovë për ta luftuar korrupsionin në mënyrë strukturore, nuk mundemi vetëm të themi po i heqim të këqijtë se vinë të tjerët të mirë, kështu nuk ka bërë kurrkush në botë. Duhet ta shohë secili veten në pasqyrë e duhet të provojë të kuptojë çka po ndodh me Kosovën strukturalist, kur edhe një pjesë e mediave edhe një pjesë e shoqërisë civile edhe një pjesë e madhe e politikës, edhe më e madhe se te mediat e te shoqëria civile, krejt po vjedhin. Çka duhet të bëjmë ne? A ka njerëz në Kosovë, që janë të gatshëm të fillojnë të mendojnë, pa e fyer njëri-tjetrin, të fillojnë të mendojnë pa dashur t'ia heqim kokën njëri-tjetrit, a po dom ta bëjmë një vend normal, a nuk po dom ta bëjmë një vend normal?

Këto janë dy aspekte, për të cilat Aleanca mendon se në Kosovë nuk jemi as të gatshëm deri më tani. Fillimisht duhet ligji shumë saktë të punojë. Dhe, në anën tjetër nuk duhet lënë vetëm te ligji, për shkak se nuk bën punë, nuk ka bërë punë kurrkund tjetër. Nëse në një vend nuk e gjen një grumbull të njerëzve normal, me një inteligjencë pak mbi mesatare, të cilët do të ulen e të thonë: a po bëjmë shtet a po lëmë krejt? Ku kemi ardhur deri tash, domethënë, jemi as këndeje as andej dhe po ma merr mendja, që në Kosovë duhet të dalin disa njerëz që thonë: a po bëjmë shtet, a po e lëmë krejt? Kështu qysh është deri tash, për nderë nuk është premtuese. Edhe unë si deputet i Kuvendit, si ish-ministër nuk ndihem mirë, absolutisht as për një sekondë. Faleminderit!

(Seancën e merr nën drejtim nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani, shefe e Grupit të Koalicionit Kosova e Re.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përsëritje për ministrat dhe deputetët!

Duke marrë parasysh se është thirrur një debat nga zonja Lama, në lidhje me çështjen e shpërdorimit të parasë publike, ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës kemi miratuar një pako të ligjeve dhe në vitin e kaluar kemi miratuar Ligjin e prokurimit publik, në bazë të rekomandimeve të Komisionit Evropian, për arsye që llogaridhënia dhe transparenca për menaxhimin e parasë publike të jetë sa më e mirë.

Në rast se shohim gjithë këtë material që është sjellë këtu, unë pikë së pari do të kërkoj edhe nga vetë qeveria, po edhe nga deputetët, që të kemi zbatueshmëri të mirë të Ligjit të prokurimit, që institucionet të cilat dalin nga Ligji i prokurimit, siç është Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit Publik, organi shqyrtues i prokurimit publik të jenë më të qartë gjatë dhënies së tenderëve dhe të dihet në fund raporti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, a janë shfrytëzuar mirë paratë publike, a s'janë shfrytëzuar.

Në rast se kemi vërejtje, ne kemi anën tjetër, se pushtetet në Kosovë janë të ndara, Legjislacioni, Ekzekutivi dhe Gjyqësori, po në rast se ne kemi dyshime për keqpërdorime, atëherë rruga është diku tjetër. Mirëpo, prapëseprapë edhe si deputetë edhe si Qeveri kemi të drejtë të tregojmë se si po menaxhohet paraja publike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS-ja? Nuk do ta marrë fjalën. Grupi 6+? Nuk donë ta marrin fjalën.

Atëherë, fjalën e ka kërkuar ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, për replikë.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Nuk e kam ndërmend të flas për insinuata patologjike dhe retorikë boshe të “Vetëvendosjes” sot, por meqenëse u thirra, po është e vërtetë, unë e kam dhënë urdhrin dhe urdhri është dashur të zbatohet edhe në mënyrë pak më rigorozë dhe dua t’ju informoj, se në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve ekzistuese, nuk do të lejohet as deputetët e “Vetëvendosjes”, as deputetët e Kuvendit, as Kryesia e Kuvendit, as kryetari i Kuvendit, as Qeveria deri te Presidenca, ta bllokojë punën e institucioneve.

Në këtë vend, në bazë të ligjeve ekzistuese dhe Kushtetutës, do të sundojë rendi dhe ligji dhe jo anarkia. Dhe, kjo është derisa të jenë të vlefshme këto dokumente, prandaj në këtë mënyrë do të veprohet edhe në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Së pari vetëm një qartësim, se prapë po gënjen ministri. Deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” janë nisur të hyjnë në objektin qeveritar, nuk jemi nisur ta bllokojmë atë. Bllokimin e ka bërë policia me urdhër të ministrit, në kundërshtim me Ligjin, i cili na e lejon neve qasjen në objektet qeveritare, institucionet publike të Kosovës pra, siç e thashë sa herë që kemi dëshirë dhe kemi nevojë.

Pra, bllokimin e ka bërë kjo Qeveri, ky ministër që e paska dhënë urdhrin.

E dyta, është që ministri nuk duhet t’i jap urdhra policisë, se ekziston zinxhiri komandues apo jo? Ky doli aty edhe dha urdhër, edhe tash mirë që e pranoi vetë, që paska dhënë urdhër. Madje, paska dhënë urdhër edhe për të na rrahur, se po thotë shumë se është dashur të jenë më rigoroz. Pra, policia nuk ia paska zbatuar urdhrin deri në fund, se kush e di çka ishte bërë.

E treta, po më flet ministri për anarkinë dhe po thotë që nuk do të lejohet kurrkush të nxisë situata anarkike në Kosovë. Po, ministër ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Futja në Qeveri në këtë mënyrë, unë jam mësuar me taktikat e “Vetëvendosjes”, që e keni dëshmuar veten dhe ato metoda të ndyra, qysh i përdorni janë të njohura për ne, prandaj edhe nuk do të ju lejojmë.

(Ndërhyrje nga salla)

KRYESUESI: Replikat u harxhuan. Edhe kjo gjuhë, nuk është gjuhë që na nevojitet hiç, as ministrit, as “Vetëvendosjes”.

Unë nga ky vend, si kryesues i kësaj seance, megjithatë dua t’i them dy fjalë.

Ju thërras të përdorni gjuhën parlamentare. Kjo vlen për të dyja palët. Kjo vlen, në radhë të parë, menjëherë po them, për ministrin. Gjuha e tij kërcënuese, ndoshta e ka gjuhë ai, nuk di ndryshe, këtu në foltore të Kuvendit që u tha në replikën e parë, jo në të dytën, se e dyta ishte joparlamentare, e para është kërcënuese. Le ta marrë mirë, le ta lexojë, le ta dëgjojë edhe një herë dhe do ta shohë që ajo është gjuhë e hyrjes në shtet policor. Unë mendoj që nuk jemi shtet policor dhe nuk do të bëhemi.

(Ndërhyrje)

Unë jam kryesues i seancës, ju jeni një ministër, shihni përgjegjësitë dhe shihni çka keni thënë. Kaq!

E ka fjalën për temën që e kemi, se e maturuam këtë problem.

(Ndërhyrje.)

Unë nuk ta lëshoj, kur të vijë rendi bisedon. Fjalën e ka Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: I nderuari kryesues i seancës!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Ideja e një kërkesë për debat parlamentar në lidhje me shpërdorimin e parasë publike nga kushdo qoftë është për t’u përshëndetur në parim, por unë e kam lexuar me vëmendje tekstin e kërkesës dhe faktet që radhiten në kërkesën e parashtruar dhe diçka në këtë paraqitje, mua personalisht më ka bërë shumë skeptike.

E para, në titullin e kërkesës theksohet shpërdorimi i parasë publike nga Qeveria e Kosovës, e cila gjatë periudhës 2010-2011 i ka shpërblyer me tenderë publikë kompanitë që e kanë mbështetur për fushatë. Shumat, të cilat na prezantohen janë shumë qesharake, sepse ato shuma të cilat në tekstin e kërkesës thuhet t’i kenë dhënë kompanitë e caktuara janë minimale, në krahasim me shpërblimet që gjoja i paskan marrë këto kompani. Për më tej, kjo ngërthen në vete një faktor të rrezikshëm, i cili çon drejt idesë që në zgjedhjet e ardhshme edhe çdo person privat të ofrojë deri në 1 000 euro për ndonjë subjekt politik, me shpresë që, sipas kësaj kërkesë, do të shpërblehen 100-fish.

E dyta, faktet e radhitura datojnë edhe para vitit 2011, por për çudi, me sa kam vërejtur, vetëm deri në vitin 2008. Ne jemi kundër shpërdorimit të parasë publike dhe duhet të jemi kundër një fenomeni të tillë, pa dyshim. Atëherë, më habit fakti pse nuk është radhitur as edhe një rast para vitit 2008. Në tekstin e kërkesës thuhet që edhe ZAP-i i ka verifikuar shkeljet e Ligjit të prokurimit, pra deri këtu ka funksionuar sistemi si duket. Shtrohet pyetja: Cilët hapa janë ndërmarrë më tej? A mund të jetë vallë që Prokuroria të ketë fjetur, apo ndoshta shkeljet nuk kanë qenë aq drastike sa të penalizohen?

E treta, nga tenderët, për të cilët dihet që financohen nga paratë që janë paraparë për projekte të caktuara, parashtruesja kërcen te varfëria qytetare, duke radhitur ca shifra të UNDP-së për gjendjen e përgjithshme në Kosovë. Për mendimin tim, kjo është dyfytërsi tipike. Nëse e marrim për bazë keqpërdorimin e Buxhetit të Kosovës si faktor vendimtar për varfërinë e qytetarëve, atëherë unë mendoj që edhe thirrja e debateve shkel e shko, e vend e pa vend, siç po ndodh në Kuvendin e Kosovës, është një keqpërdorim i tillë, pa dashur të shkojë me shifra.

Nëse edhe keqpërdorimi i mëditjeve për udhëtime zyrtare është një keqpërdorim i buxhetit, dua të theksoj që edhe parashtruesja e këtij debati shpesh ka udhëtuar në udhëtime zyrtare gjatë këtij mandati.

Nëse do të flasim për keqpërdorimin e buxhetit dhe për taksat e taksapaguesve, dua të ju them, të nderuar deputetë, që edhe njësia speciale që duhet në çdo rast t'i ruajë dhe t'i mbrojë institucionet e Kosovës, të cilat janë formuar me sakrificën e shumë bijve e bijave tona, t'i ruajë dhe t'i mbrojë nga adoleshentët dhe fëmijët e manipuluar nga "Vetëvendosja", atëherë edhe ky është një keqpërdorim. Definimi, përdorimi dhe mbikëqyrja e shpenzimeve të parasë publike në çdo aspekt dhe rreth çdo shume, qoftë deri në një euro, duhet të trajtohet me seriozitet të madh. Kështu mendoj edhe unë. Por, të bihet me tupan e me shifra dhe të pritët që gjendja të përmirësohet, nuk besoj.

Kjo kërkon punë dhe angazhim, jo vetëm nga kjo Qeveri, apo cilado Qeveri që do të jetë në pushtet, por nga secili prej nesh, në radhë të parë, në tejkalimin e inateve të vogla personale dhe appetiteve për pushtet. Problemet duhet të adresohen me emër dhe me individ, e jo të adresohen në formë grupore. Nëse ka shkelje, atëherë Prokuroria duhet ta marrë përsipër që nënshkruetin e kontratës ta vërë para drejtësisë. Problemet nuk adresohen me Gjilan, Pejë, Mitrovicë, Skenderaj etj., etj., siç keni bërë. Nëse shkojmë ashtu, atëherë përgjegjës apo fajtor nuk mund të jetë asnjëri. Më poshtë në kërkesë, nga çështja shumë prekëse e gjendjes së përgjithshme të qytetarëve, zonja Lama del te pabarazia e subjekteve politike gjatë fushatave.

Besoj që çdo qytetar e di se secila parti i ka pasur sponsorët e saj. Kjo vlen edhe për partinë e Alma Lamës. Nëse bazohemi në formën e kërkesës, atëherë a do të thotë që edhe ulëset e partisë suaj në këtë Kuvend janë të blera. Çka do të ishte mirë të kërkohej në këtë kërkesë, e që unë nuk e pashë që është e theksuar nga e nderuara. Për mendimin tim, ka shumë rëndësi për përparimin e vendit është që kriteri i parë kryesor dhe vendimtar duhet të jetë kompania, së cilës i ndahet një tender, të ofrojë punë kualitative,

sepse nëpërmjet punës kualitative përmirësohet jeta e të gjithë neve, përndryshe kompanitë të cilat nuk e bëjnë punën sipas kritereve duhet të japin llogari, qoftë me punë shtesë, qoftë me pagesë gjobe, apo me masa tjera ndëshkuese.

Vetë fakti që deputetja Lama kërkon që vetëm disa gjëra apo tenderë të verifikohen, tregon se është shumë tendencioze dhe manipuluese. Unë mendoj që kërkesa do të ishte më parimore sikur të kërkohej të kontrollohen të gjitha përdorimet apo shpërdorimet e parasë publike, e jo disa raste të veçanta. E meta thelbësore që është theksuar në kërkesë është se paskan dhënë shuma simbolike për një subjekt politik. Por, në fund, e nderuar, e kam një pyetje për ju, zonja deputete Lama: Zyrtarët e komunave tjera, të cilat besoj se kanë ndarë gjithashtu tenderë gjatë periudhës kohore, që e përmendni ju, me çfarë parash kanë punuar ata? A nuk janë edhe ato para publike të taksapaguesve që nuk e keni parë të arsyeshme ta bëni qoftë edhe një analizë sipërfaqësore.

KRYESUESI: Deputetja Alma Lama, replikë.

ALMA LAMA: Zoti kryesues!

Më vjen mirë që deputetja Musliu e paska bërë një analizë deskriptive të kërkesës sime, mirëpo zonja Musliu të tregoj që nuk e keni bërë mirë, sepse të dhënat, në të cilat unë jam mbështetur janë një raport i publikuar gazetaresk. Është investigim.

Më vjen keq, por ju asgjë nuk merrni seriozisht, as kur flitet për krimin, as për korrupsionin, as për asgjë. Po t'i kishit marrë seriozisht, gjendja do të ishte ndryshe. Ju lutem ta kontrolloni fjalorin, sepse kam përshtypje se nuk i matni mirë fjalët kur flisni. Ndërsa, për sa i përket pabarazisë, po ju them që është shumë e rëndësishme që në demokraci të ketë barazi, edhe në konkurrencën politike, sepse e kundërta është ajo çfarë po ndodh në Kosovë, kur një subjekt politik, nëpërmjet manipulimeve të tilla, nëpërmjet përdorimit të parasë publike për ta mbajtur pushtetin gjatë, për të mos e ndërruar pushtetin, çon në autokraci. Pra, nuk kemi demokraci, por kemi autokraci. Fakti që ju e shpërdoroni paranë publike për ta zgjatur jetën e pushtetit tuaj, do të thotë që ju punoni për ta ndërtuar një sistem autokrat. Është shumë e vërtetë ajo që thoni ju, që shifrat që janë paraqitur në këtë raport për subjektet, të cilat kanë dhënë para për PDK-në, nuk janë reale. Unë nuk e besoj që për 1 000 euro, një kompani që i ka dhënë për fushatën elektorale, të jetë shpërblyer me 5 000 000 euro. Mirëpo, e vërteta është që kompanitë nuk kanë deklaruar, ose PDK-ja nuk i ka deklaruar shifrat e sakta të financimit të fushatës, e ju e dini që për këtë ka vërejtje edhe KQZ-ja. Pra, kemi edhe fshehje. Kemi të bëjmë edhe me një çështje tjetër.

Gjithsesi, unë ju inkurajoj dhe prandaj e thashë që në fillim që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Koha të kaloi. Kundër-replikë një minutë, zonja Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Dua vetëm t'ia them deputetes Lama që shumë mirë e theksoi që ka bërë deklaratë mbi raporte gazetareske dhe unë e ftoj që të shkojë në vendin e ngjarjes dhe t'i verifikojë dokumentet, sepse dua ta marr vetëm një shembull për komunën time, Komunën e Skenderajt, që theksohet në kërkesë në raportin e zonjës Lama, e ku nuk e ka parë të udhës ta përmendë që në vitin 2009 kjo komunë e merr çmimin e parë për transparencë dhe shërbime në administratë. Në vitin 2010, e merr çmimin e parë si komuna me të hyra vetjake. Këto janë çmime që i ndan USAID-i, për ç'gjë është shpërblyer me nga 30 000 dollarë për punën dhe korrektësinë, e mund të flas për secilën komunë veç e veç, për punën dhe rezultatet që bëjnë.

Prandaj, e ftoj Alma Lamën, nëse e di ku është Skenderaj, që e ka përmendur në kërkesën e saj, le të shkojë dhe le ta vërtetojë në vend punën dhe aktivitetin që e bën Komuna, por edhe komunat tjera që i ka theksuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, u krye kjo. Merrni fjalën për diskutime dhe flitni. Ju lutem, ju zonja të Kuvendit, edhe zonjusha, është Rregullorja. Unë strikt jam duke e zbatuar Rregulloren. Merrni fjalën e diskutoni, por kur e përmendni dikë dijeni që keni replikë, e të mos shkojmë tutje në këtë formë. Kaq!

Fjalën tash e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Sot jemi ftuar që të bisedojmë për rendin e ditës, në debat parlamentar sipas kërkesës së deputetes Alma Lama, lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës.

Çfarë ka më normale për një Parlament, çfarë ka më normale për një demokraci sesa të bisedohet për shpenzimin e fondeve publike?! Kush i shpenzon ato fonde publike, kush i menaxhon? I menaxhon Qeveria. Prandaj, ky është një debat jashtëzakonisht normal, jashtëzakonisht në vijë të demokracisë dhe në këtë aspekt unë nuk e kuptoj pse, së pari Qeveria, nuk e pa të arsyeshme të vijë, ministër? Të vijë në fillim edhe të diskutojë në emër të Qeverisë për këtë. Fondet publike menaxhohen nga Qeveria dhe ajo normalisht që duhet të diskutojë edhe të japë përgjigje dhe llogari për shpenzimin e fondeve publike. Kjo është diçka më se normale në botë.

Në anën tjetër, fjalori se ky është debat tendencioz, se ky është debat i kalkuluar, apo se ky është debat me të cilin hyhet në fonde, apo në analizën e punës së deputetëve, të cilët nuk kanë qasje në fondet publike, tregon që këtu i paska dhembur dikujt që çohet dhe diskuton, edhe tenton që ta shpërqendrojë fokusin në diçka tjetër. Pse ka nevojë të frikohet në një debat normal ku diskutohet për fonde publike?

Në anën tjetër, diçka edhe u përmend pse do të duhej të ketë frikë, edhe pse shihet tendenca që debati të shfokusohet. Në qoftë se prej 40 auditimeve, të cilat kanë ardhur në Kuvendin e Kosovës, vetëm një ka qenë në rregull, apo vetëm 2,5% prej të gjitha auditimeve, është thënë se është në rregull, atëherë kjo me siguri tregon që debati nuk duhet të përfundojë këtu, por duhet të merren masa dhe të shihen pse raportet e auditimit të organizatave buxhetore nuk janë në rregull. Në qoftë se për dy muaj shpenzohen 2/3 e

buxhetit për organizata të ndryshme buxhetore, atëherë edhe kjo nuk është në rregull. Edhe kjo nuk duhet të mbetet në një diskutim të vetëm, por të duhej që të analizohej pse 2/3 e buxhetit shpenzohen vetëm për dy muaj, ndërsa për 10 muaj tjerë nuk ka mundur të shpenzohet?! A ka qenë prokurimi në defekt? A kanë qenë praktikatat të cilat kanë mbretëruar jodemokratike, që kanë shkaktuar që në 10 muaj të shpenzohet 1/3, ndërsa për dy muaj të shpenzohen 2/3 e buxhetit. Kjo normalisht që nuk është normale, nuk është qasja e duhur në menaxhimin e fondeve publike, e kjo duhet të sqarohet pse.

Në qoftë se 50 persona shkojnë në SHBA, duhet të shpjegohet se në çfarë mënyre menaxhohen fondet publike. Apo, më kujtohet delegacioni, i cili ka shkuar në Kroaci, edhe ku prej atje kanë thënë a është ky delegacion kinez, apo prej nga vini? Kanë mundur në atë delegacion 2-3 veta të kryejnë punë. Pse është dashur të shkojë një delegacion, që cilësohet si delegacion kinez? Dhe të gjitha këto nuk e kanë për qëllim që vetëm të gjejnë fajtorë, por e kanë për qëllim që të ngrihet vetëdija dhe këto praktika jodemokratike të mos përsëriten më.

Në anën tjetër, u përmend, edhe që duhet të theksohet, që këto fonde publike, të cilat për dy muaj shpenzohen 2/3, në fakt shkaktajnë dëme për firmat private, të cilat punojnë për Qeverinë, apo për institucione publike dhe me atë rast, jo që u ndihmohet atyre firmave, por ato firma hyjnë në borxhe dhe dëmtohen. Nuk po flas për firma, të cilat kanë afinitet, kanë lidhje me Qeverinë, apo s'kanë lidhje me të. Po flas për firmat, të cilat me të vërtetë dëmtohen, edhe e dëmtojnë zhvillimin ekonomik të Kosovës. U përmend se komplet Distribucioni është shitur për 26 milionë euro. Nuk dua të theksoj sa trafo stacione, sa kilometra linja etj., etj., por vetëm ndërtesa të në qendër të Prishtinës po të ishte shitur aq para do t'i bënte.

Gjithashtu, e dimë që Raporti i Progresit, apo raporti i të bërit biznes, apo cilido raport tjetër nuk e tregon Kosovën që është duke i menaxhuar fondet publike ashtu siç duhet. Të gjitha janë për fondet, për menaxhimin e fondeve publike dhe për punën e Qeverisë, e kjo tregon se çfarëdo zhvillimi ekonomik, apo çfarëdo kërkesë për integritet evropian, me këtë mënyrë të menaxhimit të fondeve publike edhe të buxhetit nuk na çon në një rrugë më të drejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues dhe të nderuar deputetë, Debati për të cilin po diskutojmë sot, i cili e ka për bosht tematik mënyrën e shfrytëzimit të parasë publike nga Qeveria e Kosovës, konkretisht partia në pushtet, më shumë se asnjë diskutim tjetër shpërfaq esencën e modelit politik, ekonomik dhe shoqëror që e kemi instaluar tash e sa kohë.

Substancialisht, shumica e këtyre hulumtimeve që e mbulojnë këtë sferë të jetës sonë shoqërore dhe politike tregojnë për një mpleksje të fuqishme ndërmjet sferës së pushtetit dhe biznesit, si dhe tjetërsimin e demokracisë nga funksioni i saj themelor. Pra, në këtë sens e kemi instalimin e një modeli paradoksal, që mund të quhet si një lloj kapitalizmi abuziv shtetëror, sepse e kemi një situatë, në të cilat bizneset financiarisht e mbështetin

pushtetin, kurse pushteti i shpërblen ato sipas logjikës së tenderimit. Esenca e këtij modeli fatkeqësisht qëndron në faktin se shumica e këtyre tenderëve, siç tregojnë këto hulumtime dhe investigime që janë kryer mbi shfrytëzimin e parasë publike, shpërndahen në shpërputhje me sistemin ligjor. Rrjedhimisht, pra, kemi modelimin e një sistemi që e shfrytëzon paranë publike në një mënyrë joligjore. Kështu, krijimi i kësaj strukture politiko-kapitaliste bëhet duke e shpërfillur në mënyrë arrogante ligjin, në 80% të rasteve.

Në anën tjetër, në këtë mënyrë, kjo Qeveri, më pastaj, nga një instrument për t'i mbrojtur interesat e përgjithshme dhe të përbashkëta të shoqërisë, shndërrohet në një instrument që i mbron interesat e posaçme të një pakice gjithnjë e më të vogël, e cila po bëhet gjithnjë e më e pasur, mbi kurrizin e një shumice, e cila po bëhet gjithnjë e më e varfër. Kështu, kjo harlisje e pushtetit ka bërë që ai të shndërrohet nga shërbëtori i shoqërisë në zot të tij. Dhe, ky veçim i tjetërsimit të këtij pushteti që e shohim çdo ditë nga shoqëria ka rezultuar me instalimin e një zgjedhjeje të padurueshme, që po e zhyt vendin gjithnjë e më shumë në moçalin e korrupsionit.

Ndërkaq, shoqëria në shërbim të së cilës ky pushtet propagandon se është, deri më tani në të vërtetë nuk ka mundur të bëjë asgjë dhe e tërë kjo, e tërë kjo dobësi e shoqërisë rrjedh prej faktit për shkak të kolapsit të sistemit ligjor, sistemit të drejtësisë dhe mungesës të shtetit të së drejtës. Kështu, si pasojë e kësaj fryme tjetërsuese bën që boshti i jetës politike të bëhet korrupsioni, ndërkohë kjo sjell edhe zhvendosjen e boshtit të sistemit demokratik drejt një pushteti kleptokratik. Me këtë rast, duhet të kuptuar esencën se si edhe ndërtohet dhe modelohet ky sistem, sepse për dallim nga sistemet e kaluara kur pushtetin e tyre arrinin ta mbanin në saje të dhunës së hapur mbi shoqërinë, ky pushtet tani, edhe pse me karakter të cunguar sa i përket legjitimitetit politik, edhe pagëzimin e përkrahjes së shumicës qytetare, megjithatë ka arritur ta mbajë vetveten pikërisht në saje të përhapjes totale të korrupsionit.

Pra, vendin e dikurshëm të pushtetit me dhunë e ka zënë korrupsioni, kurse leva kryesore e pushtetit politik është bërë paraja. Elemente strukturore, këto që deri më tani më shumë se asnjëherë tjetër më parë janë mishëruar me pushtetin kriptokapitalist të kryeministrit aktual, paradoksalisht edhe institucionet qendrore politike, nga mekanizma që duhet të garantojnë dhe mbrojnë substancën e lirisë publike, janë transformuar në feude financiare të grupeve oligarkike të këtij pushteti politik. Ne konsiderojmë se transformimi i kësaj gjendjeje nuk mund të bëhet brenda këtyre suazave aktuale të funksionimit institucional, pa fuqizimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë, ministri i Financave, Bedri Hamza. Le të dihet që Qeveria është ftuar, por s'ka qenë këtu në fillim, kështu që mos bëni urgjencë. Dijeni, keni ardhur më vonë! E ke fjalën, në emër të Qeverisë.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,
E nderuara zonja Lama,

Fillimisht dëshiroj të ju falënderoj për temën që e keni shtruar. Megjithëse u tha dhe shihet qartë se ka një diskrepancë ndërmjet asaj se si është emërtuar pika e rendit të ditës, që thotë: Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetes Alma Lama lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës, ndërsa në kërkesë shohim se ka diçka tjetër, bazuar në diçka, dhe këtu flitet edhe për shpenzimin e parave, edhe nga ndërmarrjet shoqërore, edhe nga ndërmarrjet publike, edhe nga komunat.

Unë me kënaqësi jam këtu. Kërkoj falje që nuk kam mundur të jem edhe në fillim dhe jam i gatshëm që të bisedojmë për të gjitha raportet për shpenzimin e parasë publike. Ministria e Financave është e obliguar, sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/ E-048, të hartojë raporte tremujore periodike për ekzekutimin e buxhetit dhe të njëjtat t'i procedojë në Qeveri, në Kuvend dhe të njëjtat të diskutohen. E kështu ka ndodhur edhe me raportin vjetor për ekzekutimin e buxhetit për vitin 2011, i cili është diskutuar në këtë Kuvend dhe thënë të drejtën nuk ka pasur ndonjë debat të gjatë rreth kësaj çështjeje dhe ai është aprovuar.

Me qëllim të rritjes së transparencës, të llogaridhënies, Ministria e Financave ka shkuar edhe një hap tutje, dhe përveç raporteve periodike tremujore, për të cilat e obligon ligji, e obligojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për raportimin në bazë të parasë së gatshme, ne hartojmë dhe publikojmë edhe raporte mujore dhe të njëjtat janë publike në ueb-faqen e Ministrisë së Financave. Tash do të ndalesha për shpenzimin e parasë publike. Nëse i referohemi raportit vjetor për vitin 2011 dhe unë këtu i kam krahasimet, duke filluar nga viti 2007, shihet një performansë e qartë, ku kemi dyfishim të buxhetit, edhe në pjesën e të hyrave, edhe në pjesën e shpenzimeve. Nëse i krahasojmë të hyrat vjetore nga viti 2007, se nganjëherë më shumë thotë një grafik se shumë fjalë, ne e shohim se në vitin 2007 në Kosovë janë inkasuar 898 milionë euro, ndërsa në fund të vitit 2011 janë 1 miliard e 303 milionë euro. Në krahasim me periudhën e vitit 2010, kemi një ngritje diku prej 10,6%.

Ndërsa, nëse kalojmë te pjesa e shpenzimeve, atëherë e vërejmë qartë se kemi thujse dyfishim në të gjitha kategoritë, por në kategori të caktuara, aty ku është interesi më i madh i qytetarëve të Republikës së Kosovës, ku janë investimet kapitale, kemi edhe trefishim. Ky është si rezultat i rritjes së performansës dhe rritjes së kapaciteteve të institucioneve në nivelin lokal dhe qendror për ekzekutimin e buxhetit. Nëse i marrim dhe i krahasojmë pjesën e shpenzimeve në Kosovë, në fund të vitit 2007, totali i shpenzimit të buxhetit ka qenë 661 milionë euro. Në fund të vitit 2011, një miliard e 388 milionë euro. Këto janë shifra dhe fakte. Kemi më shumë se dyfishim të buxhetit.

Ndërsa, nëse hyjmë në strukturë, atëherë shohim se pagat në fund të vitit 2007, fatura e pagave ka qenë 209 milionë euro, në fund të vitit 2011 - 385 milionë. Thujse kemi gati qind për qind të rritjes së këtij pozicioni.

Vazhdojmë kështu me radhë dhe vijmë te pozicioni që është më me rëndësi për qytetarët e Republikës së Kosovës, që janë investimet kapitale dhe shihet se kemi pasur një ngritje nga 155 milionë në 528 milionë. Asnjëri këtu nga ne nuk thotë që nuk ka vend për më

mirë dhe nuk ka vend për më shumë. Sa i përket përmirësimit të menaxhimit të financave publike, unë e kam këtu pasqyrën e cila është nga Zyra e Auditorit Gjeneral.

Deputetë të nderuar,

Më lejoni të theksoj se në fund apo në vitin 2008, opinione të pakualifikuara, pa rezervë, që është vlerësimi më i lartë për një organizatë buxhetore, kanë qenë katra: në vitin 2009 - 14; në vitin 2010 - 15 dhe në vitin 2011 gjithsej 34. Kjo është gjendja. Prandaj, unë e mirëpres debatin për çka do qoftë, mirëpo të thuhet debat për shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria dhe ta konsiderojnë si temë livadh, të flasë kujt çka t'i teket, pa një minimum të dijes profesionale, është goxha problem. Unë këtu sot jam i gatshëm të bisedoj edhe për raportin vjetor 2011, edhe për raportin tremujor 2012, edhe për raportin gjashtëmujor 2012, por edhe për raportin nëntëmujor të vitit 2011.

Ministria e Financave, në bazë të ligjit, në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit nuk raporton sipas asaj se kush i fiton kontratat. Ato të dhëna i gjeni në një institucion tjetër që i përgjigjet Kuvendit, që është KRPP-ja. Ministria e Financave raporton në vlera monetare për çdo cent që shpenzohet nga çdo organizatë buxhetore, dhe në këtë mënyrë ne jemi duke vazhduar dhe jemi duke publikuar raporte mujore, e të njëjtat janë publike në ueb-faqen e Ministrisë së Financave.

Nga performansa e institucioneve të Kosovës shihet qartë se ka rritje të të hyrave, ka ngritje të performansës në ekzekutimin e buxhetit, ka përmirësim të raporteve të auditorit, nga katër ka arritur në shifrën që e përmenda, dhe normalisht të gjithë jemi të vetëdijshëm se do të vazhdojmë në rritjen dhe përmirësimin e cilësisë. Nuk i ndan Ministria e Financave tatimpaguesit sipas partive politike. Është e drejtë e secilit tatimpagues ta ketë bindjen e vet politike.

Për ne janë tatimpagues, për ne e kanë një numër fiskal. Nëse të gjithë ata që kanë marrë pjesë në procedurat e konkurrimit dhe në fitimin e tenderëve të ndryshëm kanë qenë të pakënaqur me komisionet që merren me këtë punë, ata e kanë pasur të drejtën e tyre që të ankohen në institucionet përkatëse. Edhe ne i inkurajomë të gjithë ata që kanë fakte dhe dëshmi t'i deponojnë ato atje ku është vendi. Ndërsa, të flitet pa fakte dhe pa argumente...

(Ndërhyrje)

Varet çka konsideron fakt. Unë e kam të qartë që realiteti dikujt i dhemb dhe po kaloj, për të mos qenë subjektiv, te raporti i fundit i Bankës Botërore.

Ju kisha lutur, shikojeni këtë raport të fundit të Bankës Botërore! Shikojeni çfarë thotë në faqen 5! Shikojini këta grafikone! Shikoni çka thotë i njëjti raport në faqen 6, e kështu me radhë. Prandaj, unë e mirëpres debatin, por realisht është vështirë të debatohet kur nuk dihet për cilin raport, për cilën periudhë po debatojmë. A për tremujor, a për gjashtëmujor, a për nëntëmujor? Ndërsa kjo çfarë shkruan në kërkesë dhe që është paraqitur si pikë e rendit të ditës ka diskrepancë. Unë, duke ju falënderuar, jam në dispozicion të deputetëve të nderuar për përgjigje në të gjitha interesimet e deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Shikoni, u thërras të gjithë deputetët, nëse kërkon të mos zhurmohet, mësojuni të mos zhurmoni asnjëri. Kaq! E ka fjalën deputeti Gërbeshi.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot po bisedojmë për një pikë shumë të ndjeshme, për të cilën unë e falënderoj sponsoruesen që e ka sjellë këtu dhe na e ka vënë përpara që të bisedojmë.

Nëse themi, a ka keqpërdorim të fondeve publike apo nuk ka, unë deklaroj publikisht se ka. Dhe, nuk besoj që është dikush në Kosovë që mund ta mohojë një çështje të tillë. E para është kjo, dhe e keqja më e madhe që i ka ndodhur këtij vendi është se korrupsioni është shndërruar në institucion, të cilin e kemi shumë të vështirë ta heqim nga vetja dhe madje duhet një përpjekje jashtëzakonisht e madhe e të gjitha institucioneve, e sidomos i Qeverisë për ta larguar këtë të keqe shumë të madhe dhe shumë të dëmshme për vendin tonë. Ka vite që korrupsioni dhe keqpërdorimi i parasë publike po e shkatërrojnë këtë vend, po e shkatërrojnë këtë popull dhe po na shkatërrojnë të gjithëve.

Nuk besoj, përsëri po them, që është dikush që nuk e di këtë. E dinë të gjithë, por varet se kujt i pëlqen ta thotë, e kujt nuk i pëlqen ta thotë. Unë po i përmend disa raste të keqpërdorimit të parasë publike, sidomos në mallra dhe shërbime: Janë shumë e shumë raste ku paraja publike është keqpërdorur në mallra dhe shërbime, në disa dikastere të ministrive, por edhe ashtu në pushtetin lokal. Po e përmendi keqpërdorimin sidomos të veturave zyrtare, dhe të gjithë jemi dëshmitarë se veturat zyrtare përdoren pas orarit të punës 24 orë në ditë, madje jo vetëm brenda territorit të Kosovës, por edhe jashtë tij, dhe kjo është një keqe shumë e madhe. Pastaj, keqpërdorimi i telefonave, pastaj keqpërdorimi shumë i madh në disa dikastere të ministrive, sidomos në Ministrinë e Shëndetësisë, pastaj të Arsimit, pastaj të Tregtisë dhe Industrisë, e ministri të tjera, të Zhvillimeve Ekonomik etj., të cilat janë evidente dhe shihen publikisht.

Dhe kisha ardhur deri te e keqja më e madhe dhe e fundit, që është tenderizmi, i cili nuk ka nevojë të komentohet, sepse e dimë që ka keqpërdorim masiv dhe askush në Kosovë nuk mund ta mohojë një çështje të tillë, por megjithatë neve na dhemb keqpërdorimi i parasë publike.

Po e përmendi vetëm një rast. A ka arsye apo jo, le të vlerësohet nga të tjerët. Është bërë publike një herë që një veturë zyrtare, e një ministreje tonë këtu, qëndron dy orë ndezur para derës së Parlamentit. Është bërë publike. Por, unë ju garantoj se atë veturë e kam parë të paktën edhe dy herë të tjera, madje edhe nga një orë e dy orë ndezur, duke e pritur ministren derisa të dalë nga Parlamenti. Ky është keqpërdorim. Ky është keqpërdorim shumë i rëndë i parasë publike, sepse ajo makinë shpenzon dhe nuk besoj se është 'dikushi' ajo ministre që të pritet një orë e dy orë me makinë ndezur para derës së Parlamentit.

Çështja tjetër janë udhëtimet zyrtare. Ka shumë raste, unë po e përmendi një rast, i cili është bërë publik në një gazetë dhe pastaj është heshtur, sepse në një delegacion tonin ka

pasur shpenzime enorme jashtë, madje aty është pirë edhe shishja e shampanjës që ka kushtuar 200-300, e 700 euro. Edhe ky është keqpërdorim, sepse është fjala për paranë publike, sepse të gjitha këto paguhen nga paraja e shtetit tonë. Prandaj, unë jam për atë që Qeveria t'i rishikojë politikën e saj të përdorimit të parës publike, t'i eliminojë këto të meta të mëdha, madje të shohë se në cilët sektorë dhe segmente të saj ka keqpërdorime dhe normalisht të bëjë atë që është e mundur për ta ndaluar një keqpërdorim të tillë masiv të parës publike.

Jam i mendimit që nuk ekziston një vullnet i duhur në këtë Qeveri të Kosovës, që është sot, për ta luftuar korrupsionin, krimin e organizuar, për ta ndaluar keqpërdorimin e parës publike. Po ta kishte një minimum të vullnetit dhe të dëshirës për ta bërë këtë, jam i bindur se do ta bëjë, por nuk ekziston.

Për këtë ka shumë e shumë fakte, por tash po bisedojmë për këtë temë, e cila besoj se do të preket edhe nga të tjerët, edhe nga deputetë tjerë dhe se, në fund, nuk na mbetet gjë tjetër, veçse ose të apelojmë, ose të lutemi që paraja e shtetit të mos konsiderohet si një para, të cilën gjithsecili mundohet ta grabisë dhe të pasurohet nëpërmjet saj, po të shikohet si një para e shenjtë, e cila duhet të vihet në shërbim dhe të zhvillimit të vendit dhe të ekzistencës së popullit tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetë të nderuar, duhet të ju informoj që ta kemi të qartë, që ta kemi një kombinim në dhënien e fjalës. PDK-ja ka ofruar këta diskutues: Xhevahire Izmaqi, Salihe Mustafa, Valbona Dibra, Blerta Deliu-Kodra, me firmën e shefit të grupit.

LDK-ja ka: Hykmete Bajrami, Haki Demolli, Armend Zemaj; "Vetëvendosja" ka: Albin Kurtin; AAK-ja e ka Xhevdet Nezirajn. Normalisht, që të gjithëve përnjëherë s'jua jap fjalën, përpiqem ta bëj njëfarë rendi si zakonisht. Tash fjalën e ka ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

U përmend më herët këtu se u fal, se u shit Distribucioni. Mendoj që është mirë që t'ua shpjegojmë edhe një herë qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët janë me të vërtetë ata, të cilët e meritojnë atë trajtimin më të mirë të mundshëm, e jo të provokohen në baza ditore, me veprime jopolitike dhe veprime jodemokratike.

Procesin e privatizimit të Distribucionit ne tri herë e kemi diskutuar në Parlament. Ky Kuvend, këta deputetë e kanë aprovuar realisht një proces të tillë dhe ai proces është publikuar. Është shumë me rëndësi të thuhet se qytetarët e Republikës së Kosovës, konform strategjisë, e cila prapë është miratuar nga Kuvendi, të kërkojnë furnizim më të sigurt me energji, furnizim më të përballueshëm me kosto më të mirë dhe trajtim të ambientit në nivelin maksimal.

Ne me këtë proces kemi vënë në funksion standardet më të larta ndërkombëtare, transparencën më të lartë të mundshme. Çmimet i përcakton tregu, por ajo çka është shumë e rëndësishme, sepse është manipuluar shumë me ndjenjat e punëtorëve dhe të qytetarëve me atë se do të largohen apo nuk do të largohen. Unë po e them edhe një herë publikisht për qytetarët dhe për punëtorët, jo për deputetët, të cilët kanë miopi ekonomike nganjëherë, se asnjë punëtorë nuk do të largohet nga Distribucioni për tre vjet. Këto kontrata janë të vlefshme për punëtorët, të cilët kanë pasur kontrata të përkohshme. Dhe, kontratat e përkohshme nënkuptojnë kontrata 1 deri në 6 muaj. Pra këtyre njerëzve u ka garantuar për 3 vjet, ndërsa kontratat e përhershme janë të transferuara sipas Ligjit të punës dhe do të transferohen si kontrata të përhershme. Prandaj, ju lutem, mos tentoni të hidhni hi syve të publikut, të luani me ndjenjat e qytetarëve, sepse kjo është një dëshmi dhe, fundi fundit, ajo çka është e rëndësishme - nga ky investim ne presim 300 milionë euro investime, të cilat do të shkojnë, jo në favor të partive politike, të cilat po dëshirojnë të tregojnë një lloj patriotizmi ekonomik të vonuar, por qytetarëve të Republikës së Kosovës. Janë 300 milionë euro investime, të cilat parashihen të bëhen.

Kjo është e vërteta e Distribucionit, kjo është e vërteta që Kuvendi e ka miratuar një proces të tillë dhe për të gjithë ata, të cilët po flasin për keqpërdorime. Me gjuhë politike, duke aluduar se edhe e dinë kush janë keqpërdoruesit, po ju bëj me dije edhe një herë të gjithëve, që të gjithë ata, të cilët dinë kush është fakti për keqpërdorim janë përgjegjës para ligjit, nëse atë e fshehin. Pra, ju bëj thirrje të gjithëve ju që e dini që ka keqpërdorime dhe keni fakte, urdhëroni shkoni atje, por mos bëni politikë, mos i malltregoni qytetarët, sepse transparenca dhe llogaridhënia është edhe e atyre. Prandaj, nëse i dini faktet dhe nuk i thoni, jeni pjesë e një procesi të tillë, që po tentoni t'i fshihni informacionet. Prandaj, ta dini që përgjegjësia penale mbetet edhe mbi ju. Faleminderit!

KRYESUESI: Albin Kurti e ka fjalën. S'ka replikë! Hajde, një minutë. Por më mirë të flitet sistematikisht, se t'i gjuhen fjalë njëri-tjetrit. Urdhëro! E ka fjalën Visari Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Së pari ministër, sa i përket diskutimit në Kuvend, ne e kemi thënë edhe më parë, dhe nuk është çështja a është diskutuar në Kuvend a jo, se privatizimi i rrjetit natyrisht që është diskutuar në Kuvend, por vendim të Kuvendit nuk ka as për Rrjetin, e as për Postën. Këtë ta kesh parasysh, për asnjërin. Vendimi që është nxjerrë nga Kuvendi në vitin 2008, është vendim në parim, të cilin në asnjë pikë nuk e keni përmbushur në momentin kur e keni privatizuar. Kjo le të dihet.

E dyta, 26,3 milionë euro, mendoj që edhe ti e di, që është çmim qesharak. Por të mos flasim për këtë hiç. Çështja e tretë, meqenëse është koha e shkurtuar - ju thatë që 300 milionë euro do të investohen për 15 vjet. A e keni llogaritur sa i bie në ditë të investohen, zoti ministër, se unë e kam llogaritur. Në ditë i bie diku 4 000 euro. Ndërkohë, a e dini ju që vetëm prej faktuarave, vetëm si kosto, që është fikse për lidhje, nga 416 000 konsumatorë, i merr diku 800 000 euro në muaj ai që e ka blerë, domethënë pa shërbyer kurrë hiç, pa punuar fare ai i merr 800 000 euro...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë e ke.

VISAR YMERI: Edhe çështja tjetër, edhe një çështje në fund, për punëtorët. Ju tashmë jeni duke përjashtuar punëtorë nga puna. 50 punëtorë i keni larguar nga Distribucioni në rajonin e Pejës (Pejë, Deçan dhe Burim). Ndërkohë që keni paraqitur konkurs për t'i marrë 75 të tjerë, edhe po thoni: “me Ligj të punës do të mbrohen”. Ministër, Ligji i punës e lejon ta largojë prej punës kënd të dojë, kur ta blejë, kur ta marrë nën menaxhim, do ta ketë këtë të drejtë. Mos i rreni punëtorët!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, ministri Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Unë nuk dua të lëshohem në gjuhën çfarë deputeti e përmend, kur thotë “po rreni”, sepse nuk ma lejon kultura. Le të mbetet në gjuhën e tij parlamentare të tij, por dua ta përkujtoj deputetin se demokracia parlamentare nuk është ajo që e ke zgjedhur ti, apo tjetri, apo tjetri në mënyrë individuale. Kuvendi kur të marrë vendime, pa marrë parasysh a ke votuar apo nuk ke votuar, janë obligim, sepse ke dashur të hysh në Parlament dhe kjo është demokracia parlamentare - votohet me shumicë dhe për ta rikonfirmuar edhe një herë se vendimi, i cili është marrë nga ky Kuvend është i plotfuqishëm, është informuar Kuvendi para debatit të parë, para interpelancës që ju e keni kërkuar që të rishikohet edhe një herë baza ligjore. Keni vënë mocion, ne e kemi njoftuar Kuvendin e Republikës së Kosovës se të gjitha kushtet janë plotësuar dhe ky debat i fundit, edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Le ta kryejë edhe pak.

BESIM BEQAJ: ...kryesues, mendoj që në çdo debat, Qeveria e ka edhe të drejtën e vet të flas, prandaj do të isha shumë mirënjohës që të mos bëni grimasa, të gjithë jemi institucione, të gjithë kemi një background që kemi ardhur këtu, edhe profesional, edhe politik, edhe moral, edhe kredibilitet. Prandaj, në këtë kontekst, dua të flas para qytetarëve, jo për juve, sepse ju keni mendje të ndritura ekonomike, juridike, politike, të cilat sigurisht që nëse do të dëgjoheshin por, fatmirësisht, nuk po dëgjohen, do ta çonin këtë vend në kolaps, edhe politik, edhe ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Botimi i Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese tregon që mbi 100 milionë euro kanë pasur përfitim kompanitë që i kanë financuar dy fushata të PDK-së dhe së paku 25 zyrtarë të lartë publikë nuk i kanë deklaruar të gjitha bizneset.

Ky botim, e paraqet në mënyrë shumë të qartë të dokumentuar rrethin e korrupsionit, rrethin e krimit të organizuar dhe botimi i këtillë tregon qysh politikani i PDK-së nëpërmjet një familjari të tij e regjistron një kompani biznesi që fiton tenderë nga ndërmarrjet publike dhe e financon më pas PDK-në e këtij politikani. Pra, ky është ky

rrethi i korrupsionit ku janë milionat në pyetje dhe sigurohet marrja e pushtetit dhe mirëmbajtje e vetes në pushtet.

Ky botim i Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese tregon që shteti Kosovë është i kapur. Pra, Republika e Kosovës është një shtet i kapur dhe ne po flasim sot këtu, sepse diku tjetër nuk po veprohet. Prokuroria, gjyqësia, sistemi i drejtësisë do të duhej që moti të veprojnë për këtë çështje, mirëpo ne po flasim sepse atje nuk po veprohet dhe kjo është një dëshmi më shumë se Republika e Kosovës është shtet i kapur.

Ne dëgjuam se etiketohemi, duke na thënë që po kërkojmë një lloj patriotizmi ekonomik të vonuar, mirëpo unë kisha dashur t'ia shpjegoj ministrit Beqaj se patriotizmi nuk është i kufizuar në kohë. Patriot duhet të jesh për çdo ditë, për çdo javë, për çdo muaj e për çdo vit, tërë jetën tënde. Pra, nuk mund të thuash që jam patriot ose duhet të jemi patriot deri më datën 7 janar, apo deri më datën 12 prill, por patriot duhet të jemi tërë jetën. Pra, nuk ka patriot me korrespondencë, ka patriotë, ose jopatriotë.

Edhe francezët, edhe gjermanët, edhe sllovenët, edhe amerikanët që i kanë shtetet e tyre shumë moti janë patriotë për çdo ditë. Ata kanë shumë më pak nevojë që të jenë patriotë, mirëpo ja që janë patriotë. E ne kemi shumë më tepër nevojë, por ja që e kemi një Qeveri, e cila nuk e kupton patriotizmin. Nuk është patriotizmi si fakultet ose shkollë e lartë që e kryen një herë, dhe e mban diplomën tërë jetën. Patriot duhesh të jesh deri në fund të jetës. As nuk është si një sëmundje, si puna e fruthit ose e lisë së ujit, që e kalon edhe mandej thua se ajo ishte një fazë në jetën time. Patriotizmi nuk është fazë. Patriotizmi është gjendje e qenies së patriotit tërë kohën sa i zgjat atij jeta.

Më tutje, unë jam shumë i bindur që shtetndërtimi dhe zhvillimi në Kosovë i ekonomisë, i shoqërisë, janë të pamundura, përderisa e kemi konkurrencën e sundimit të ligjit si koncept dhe të privatizimit si projekt për eliminimin e korrupsionit. Ju e keni parë qysh edhe privatizimi i egër në Kosovë thirret se po e lufton korrupsionin, edhe sundimi i ligjit arsyetohet me luftën kundër korrupsionit. Por, kjo konkurrencë ndërmjet privatizimit dhe sundimit të ligjit është konkurrencë jo fer, sepse sundimi i ligjit e lufton korrupsionin në bazë të ligjeve përgjithësisht të mira që nuk zbatohen, ndërkaq privatizimi e lufton korrupsionin në mënyrë të paligjshme, ndërkohë që zbatohet me shpejtësi.

Pra, privatizimi po zbatohet pa ligj, me shpejtësi, në emër të luftimit të korrupsionit nëpër ndërmarrje publike, më herët shoqërore, ndërkaq sundimi i ligjit e lufton korrupsionin me ligje të mira, të cilat nuk arrijnë ta mundin korrupsionin, sepse asnjëherë po thuajse nuk zbatohen.

Pra, nuk mund ta ndërtojmë shtetin, përderisa kemi e vënë në konkurrencë projektin e privatizimit me konceptin e sundimit të ligjit. Korrupsioni luftohet me sundim të ligjit, ndërkaq privatizimi duhet të jetë pjesë e një programi për zhvillim ekonomik me ç'rast duhet të mendohet pse të privatizojmë, kur të privatizojmë, ku të privatizojmë, si të privatizojmë, sa të privatizojmë dhe kujt t'ia bartim pronësinë me rastin e privatizimit.

Pra, konkurrenca e këtillë ndërmjet sundimit të ligjit dhe projektit të privatizimit është konkurrencë, e cila na ka sjellë në këtë gjendje, kur nuk kemi as zhvillim ekonomik, e as shtetndërtim.

Natyrisht që nuk mund ta luftojnë korrupsionin këta të cilit e kanë privatizimin e egër prioritet. Në momentin që t'i thua duhet ta shesim një ndërmarrje, ta privatizojmë një ndërmarrje, sepse aty ka korrupsion, atëherë korrupsioni bëhet interes vital i privatizuesve.

Kjo Qeveri që e ka prioritet privatizimin e ndërmarrjeve publike pas atyre shoqërore, nuk mund ta luftojë korrupsionin, sepse korrupsioni është argumenti kryesor për privatizimin. Këta e shesin KEK-un më herët, Aeroportin e dhanë me koncesion, nesër PTK-në, pasnesër do ta likuidojnë “Trepçën”, mandej ndoshta edhe ujësjellësin, kanalizimin, e kështu me radhë, sepse kemi korrupsion. Korrupsioni është interesi vital i kësaj Qeverie, sepse e ka prioritet privatizimin. Prandaj, është kundërrthënie logjike që njerëzit që e kanë prioritet privatizimin e egër dhe abuziv ta luftojnë korrupsionin dhe këta të cilët nuk qenë në gjendje ta luftojnë menaxhmentin e korruptuar, bëjnë edhe privatizim të korruptuar.

Si mund t'i besojmë ne një Qeverie që thotë se nuk mund të ketë menaxhim të pakorruptuar, se do të bëjë privatizim të pakorruptuar.

Tjetra? E dëgjuam ministrin që tha se çmimet i përcakton tregu. Po mirë, me rastin e kontratës “Behtel&Enka”, kilometri i asfaltit 10 milionë euro, trefishi i çmimit, cili është ai treg i lirë që e përcaktoi një çmim të tillë. Na kanë premtuar ekonomi të tregut të lirë. Po le t'i kemi çmimet e tregut pra, ama nuk po i kemi çmimet e tregut. Nuk është kjo ekonomi e tregut të lirë.

Tjetra? E kemi faktin që shumë politikanë janë bërë milionerë. Cili është ai treg i lirë që politikanin ultra të varfër e bënë super të pasur nëpërmjet politikës? Si u bënë këta politikan biznesmenë? Nuk e trashëguan ndonjë pasuri prej paraardhësve të tyre. Cili na qenka ai treg i lirë që e bën politikanin biznesmen dhe milioner?

Dhe, e keni parë qysh kryeministri ynë disa herë në seancën e kaluar tha “ekonomia e lirë e tregut”. Nuk dinë as t'i thoshte. Nuk thoshte “ekonomia e tregut të lirë”, po “ekonomia e lirë e tregut”. Po kjo ekonomia e lirë e tregut po na kushton shumë shtrenjtë. Pra, nuk bëhet fjalë vetëm për procese të pandershme të korruptuara, por edhe për njerëz të paditur aty.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, në një intervistë, e ngatërronte tensionin elektrik me fuqinë, i ngarronte kilovoltët me megavatët. E kuptoni, bëhet fjalë për njerëz që janë tepër të relaksuar e të paditur për të na përfaqësuar.

Dhe, së fundi, desha të them që ky vend nuk përparon derisa ministrat qeveritarë nuk janë shtresë e mesme. Me milionerë në Qeveri nuk ecet përpara, sepse populli ynë është i varfër. Edhe në Gjermani po të jenë milionerët në Qeveri, shteti kolapson, sepse ata e shikojnë maksimizimin e profitit. Ne kemi nevojë për ministra e Qeveri që janë të

shtresës së mesme. Nuk po them të jenë të varfër, po të jenë të shtresës së mesme. Besoni, ai që i ka 5 milionë euro nuk mund ta përfaqësojë atë që ka mbetur me 5 euro në xhep. Ata shqip mund të flasin me njëri-tjetrin, por nuk merren vesh.

Pra, përfaqësimi kolapson aty dhe ne kemi qeveritarë milionerë brenda natës nëpërmjet politikës dhe ky dokument që e kemi përpara, i Qendrës Kosovare për Gazetari Hulumtuese, është edhe një dëshmi më shumë se në fakt në Kosovë ka ngecur edhe shtetndërtimi, edhe zhvillimi ekonomik, për shkak se kemi shtet të kapur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë, fjalën e ka kërkuar ministri Bedri Hamza.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

E thashë edhe në paraqitjen time të parë se goxha po i përngjan një debati - debat livadh, dhe diskutimet nuk janë të koncentruara dhe nuk janë të përqendruara në pikën e rendit të ditës. Ne kemi thanë edhe më herët se mund të kem dallime konceptuale. Ka të atillë që mendojnë që modeli i zhvillimit ekonomik dhe koncepti ekonomik më i mirë është ai ku është Trocki, Stalini, ai i “kollhozeve”, “sollhozeve” të kooperativave bujqësore. Unë e kam shkollimin për t’i ditur, ndërsa disa që po flasin, po thirren në tema profesionale, por nuk e kanë përgatitjen adekuate për t’i ditur.

Nuk duhet të frikohen shqiptarët pse shqiptarët bëhen të pasur. Të gjithë shqiptarët e Kosovës, të gjithë qytetarët e Kosovës, gjithë populli i Kosovës, pa dallim etnie. le të bëhen të pasur me punë, le të bëhen të gjithë milionerë. Ne duhet ta tejkalojmë atë logjikën që ta luajmë rolin e gjynahut, edhe shteti ta luajë rolin e gjynahut, edhe qytetari ta luajë rolin e gjynahut dhe në këtë drejtim të mbetemi pafundësisht të mbetemi të varfër. Të gjithë ne duhet të punojmë, pozitë dhe opozitë, që të krijojmë ligje të mira, që të krijojmë infrastrukturë, që të krijojmë parakushte, që të krijojmë kuadro, të cilat mundësojnë zhvillimin ekonomik të këtij vendi. Është e vërtetë që ky vend viteve të fundit ka shënuar një rritje ekonomike, që është për t’u vlerësuar. Është shumë e vërtetë që ky vend ka nevojë për një rritje ekonomike edhe më të madhe seç është kjo.

Prandaj, i pranoj dallimet konceptuale, mirëpo nuk e pranoj logjikën që ky vend të mos ketë progres, të mos ketë përparim, se biznesmenët, të cilët në Kosovë kanë punuar me djersë, me punë janë bërë milionerë, dhe se ajo është diçka e keqe. Jo mor, ata punojnë për vete...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Albin Kurti, një minutë replikë.

ALBIN KURTI: Po. Është e vërtetë që populli ynë është në gjendje të mjerueshme. Të dhënat e thonë këtë, varfëria ekstreme, papunësia, e kështu me radhë. Unë nuk thashë që politikanët të jenë për gjynah, por thashë të shtresës së mesme. Pra, mos më keqinterpretoni dhe mos harroni që etiketimi është dështim në të menduar. Ju kur e etiketoni, në vend se ta analizoni çfarë po them unë, ju flisni çfarë po ju përkujtoj unë. Ama ky është dështim në të menduar.

KRYESUESI: A ke qejf edhe një fjalë ta thuash? Thuaje, por jashtë teme jemi krejt!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Zoti nënkryetar,

Unë pajtohem që jemi totalisht jashtë teme, por ne nuk dolëm jashtë teme. Tash debatin e zhvendosëm thuaja se në rrafshin filozofik dhe kisha pasur dëshirë që secili t'u përmbahet koncepteve të veta dhe modeleve të veta të zhvillimit ekonomik. Fokusohem në temën konkrete dhe njerëzit kur janë të papërgatitur të ballafaqohen me fakte, me shifra, ata e zhvendosin temën dhe të mos presë dikush që me një fuqi të kufizuar të votës mund t'i dirigjojë vendimet, të cilat i marren institucionet. Institucionet merren me shumicë, edhe është mirë të flitet në proporcion me fuqinë e votës që e ka. Jo më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra, ju që jeni këtu,

Mua me të vërtetë po më vjen keq për fenomenin që taksat e qytetarëve të Kosovës po keqpërdoren. Kjo nuk ka dyshim. Mua më vjen shumë keq kur një ministër mundohet t'i mbrojë edhe 18 ministra tjerë. Do të ishte mirë që të gjithë të jenë të pranishëm edhe gjithsecili ta mbrojë pjesën e vet. Dëshmitë janë kudo rreth nesh. Janë pasuritë multimilionëshe të zyrtarëve të lartë publikë, janë pallatet e tyre shumëkatëshe, veturat luksoze, gjithçka tjetër.

Qeveria madje po përkujdeset që edhe me ligje, me bazë ligjore, ta amnistojë këtë pasuri të fituar në mënyrë të paligjshme. Ne e patëm rastin në seancën e kaluar, kur deputetët e koalicionit e votuan ligjin, i cili e bën komplet amnistimin e kësaj pasurie të fituar në mënyrë të paligjshme.

Se kjo Qeveri po i keqpërdor taksat, po se po, po ajo po i keqpërdor edhe institucionet e Kosovës, institucionet dhe asetet publike, duke e shitur për shembull Distribucionin, duke u thirrur në atë se e kanë një vendim të Kuvendit. Po, e kanë vendimin që e përfaqëson një pakicë, e kemi parë të shprehur edhe në vota. Pasi ministri tha flitni aq sa e keni kapacitetin e votave, vota më shumë ka pasur kundër për privatizimin e Distribucionit sesa për, por Qeveria sot e ka nënshkruar kontratën edhe kanë pirë shampanjë, prandaj janë vonuar të vijnë në këtë debat.

Se ka keqpërdorime, unë do ta them edhe një rast shumë eklatant. Në seancën e fundit, Qeveria e ka propozuar Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave. A e dini kë e ka propozuar? Ministri edhe më herët i ka sjellë 6 anëtarë, disa prej të cilëve i kemi njohur dhe në mënyrë shumë korrekte i ka tërhequr. Tash nuk është votuar herën e kaluar, do të vijë në seancën sigurisht të ditës së nesërme. Njëri prej tyre është vëllai i një zëvendësministri, i cili ka ankesë në Administratën Tatimore. Kjo Qeveri i sjell njerëzit në Bordin të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave për t'i shqyrtuar ankesat e tyre. Merreni shikojeni! Bile ky edhe biografinë e vet e ka gjysmën në gjuhën shqipe e gjysmën në gjuhën serbokroate.

Tjetri është i afërm i këshilltarit të lartë politik i kryeministrit Hashim Thaçi. A nuk është ky keqpërdorimi i fondeve publike? Sigurisht që po.

Në dokumentet e Auditorit Gjeneral, në raportin e auditimit për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (ministri shkoi, nuk është këtu), auditori, ndër të tjera, thotë se Ministria e Zhvillimit Ekonomik si aksionari kryesor i aseteve publike duhet të ketë takime të rregullta me bordet e këtyre ndërmarrjeve. A është takuar ndonjëherë? Nuk është takuar asnjëherë. A e dini se çka ndodh me bordet e pavarura të ndërmarrjeve publike. Të jua them veç një shembull. Kompania “Hidrodrini”, kompani publike në Pejë, anëtarët e bordit të saj, në emër të performansës së mirë, marrin 23 paga për vitin 2011. Anëtarët e bordit i kanë marrë 23 paga. Kanë 61% humbje teknike të ujit që faturohet, kurse nga 39% që u faturohet qytetarëve, vetëm 42% arrijnë ta inkasojnë. A është kjo performim? Kush duhet të jetë përgjegjës për këtë? Normalisht, Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Dhe, cila është përgjegjësia? Jemi pikërisht në temë.

Ato faktet aty që kompanitë e caktuara kanë dhënë donacione prej 1 000 euro, normalisht ashtu kanë qenë të dhënat edhe ashtu janë paraqitur. Se nuk duhet të bazohemi në raporte gazetareske, besoj se kjo është një qasje shumë e gabuar, sepse atëherë në çfarë të besojmë nëse ne nuk besojmë në fakte, në emrat e bordeve që janë komplet politikë; nëse nuk besojmë në faktet me të cilat ndeshemi çdo ditë, nëse nuk u besojmë institucioneve që merren me gazetari hulumtuese, atëherë në çka duhet të besojmë.

Se sa ka keqpërdorime, e kam edhe një shembull tjetër. Unë besoj që ato 239 mijë euro nuk janë donacionet e vetme që merr PDK-ja. Sigurisht që merr më shumë edhe ato nuk i ka të shprehura.

Gjatë fushatës së vitit 2010, kur partia në pushtet i fitoi zgjedhjet, ju kujtohet shumë mirë spoti shumë famoz, i cili transmetohej në televizionin publik - RTK, 20 herë në ditë “Votoni për kryeministrin, Hashim Thaçi, se ky jua fali librat”. Domethënë, kjo Qeveri mendon se edhe buxheti është i veti, edhe taksat e qytetarëve mendon që janë të vetat. Merreni me mend, Hashim Thaçi po ua falka librat nxënësve! Po librat me paratë e kujt blihen? Blihen me paratë e buxhetit. Buxheti nga paratë e kujt vjen? Vjen nga taksat e qytetarëve. Bile dua të ua përkujtoj qytetarëve, se edhe ata që nuk janë në punë, edhe ata që nuk kanë kulm mbi kokë dhe jetojnë me lëmoshën e të tjerëve, sa herë ta blejnë një litër qumësht ose një kilogram bukë, ata paguajnë 16% TVSH. Dhe kjo Qeveri është e korruptuar dhe është shumë keq kur dikush nga ministrat, që ndoshta e ka performansën më të mirë, e merr barrën të dalë e t’i mbrojë ata të tjerët, të cilët nuk janë askund. Domethënë ka fakte ngado që të sillesh se janë të korruptuar dhe këtë s’mund ta ndryshojë askush. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Pas çdo njërit, a?! Urdhëro! Ministri, replikë.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Më tepër për sqarim, ngase u përmend Bordi për Rishqyrtimin e Ankesave. Deputetja e nderuar e di që reforma fiskale është në zhvillim e sipër, e di që i kemi aprovuar të gjitha ligjet. Prej datës 1 janar të vitit 2013 kjo kalon në Divizionin Fiskal në gjykatën

kompetente. Bordi aktual e ka mandatin brenda një viti t'i kryejë lëndët që i ka në dispozicion. Ligji e përcakton qartë se si procedohen nëse janë anëtarë të këtij bordi. Mirëpo, për të ecuar një hap tutje kemi kërkuar që gjithmonë për ta përjashtuar maksimalisht sa është e mundur politikën nga ky institucion dhe për këtë qëllim është bërë reforma fiskale. Për këtë qëllim është transferuar në Divizion Fiskal në gjykatën kompetente. Ne kemi kërkuar nga asociacionet e biznesit që t'i propozojnë kandidatët. Është e drejtë e patjetërsueshme e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe e Kuvendit që t'i pranojë apo të mos i pranojë të njëjtit kandidat.

Prandaj, nuk është mirë të shtrohet çështja në këtë formë, në mënyrë tendencioze, pa asnjë argument dhe çka edhe nëse dikush qenka kushëri i dikujt, edhe nëse po e plotësuaka anën formale juridike? A po u dashka të vdesë urie pse e paska dikë në Qeveri, ose e paska dikë në institucione? Nuk ka konflikt interesi edhe nëse kandidatët e propozuar kanë qenë kandidatë edhe në bordin paraprak.

Ndërsa sa u përket çështjeve tjera, Qeveria ka kompetencë t'i mbledhë të hyrat, t'i shpërndajë ato dhe t'i vendosë prioritetet. E një prej prioritetëve ka qenë librat falas për të gjithë nxënësit prej klasës parë deri në klasën e nëntë. Dhe është mirë. Kjo do të vazhdojë prapë dhe sigurisht se edhe në të ardhmen të gjithë nxënësit duhet të gëzohen se do të përfitojnë libra falas prej klasës së parë deri në të nëntën, ngase është edhe obligim ligjor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Një minutë për zonjën Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Unë nuk e di se si mund quhet jo konflikt interesi, kur një person, i cili ka ankesë në Administratën Tatimore zgjidhet në Bordin e Pavarur. Domethënë unë nuk e di nëse ai ka qenë më herët, nuk e di si ka mundur të qëndrojë aty. Edhe ky bord është i përkohshëm, po ky bord do të shqyrtojë edhe 2 000 ankesa. A kishe mund të na tregosh se sa është vlera monetare e atyre 2 000 ankesave, sepse ky personi në fjalë e ka ankesën në vlerë rreth 800 mijë euro dhe sigurisht që vetvetes nuk do t'ia refuzojë atë.

Edhe ne jemi për t'ua dhënë nxënësve librat falas, por jo me t'u thuhet që librat po ua falë Hashim Thaçi, por t'u thuhet se këto libra janë nga paratë e taksapaguesve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Përgjigje pyetjes. Urdhëro ministër!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, nënkryetar!

Deputetja e nderuar, e di ose të paktën duhet ta dijë që këtë bord nuk e zgjedh Qeveria. Këtë bord e zgjedh Kuvendi. Kuvendi është ai që vendos a do të jenë këta. Nëse nuk do ta pranosh Kuvendin të cilin ti je e ulur, është çështje jotja, unë nuk hi në atë, po këtë bord e zgjedh Kuvendi. Këta anëtarë kalojnë edhe në Komisionin për Buxhet e Financa, edhe në Kuvend. Në cilin të keni vërejtje, Kuvendi le ta refuzojë. Nuk ka kurrfarë problemi. Ndërsa sa i përket çështjes së librave, ky është prioriteti i lartë i Qeverisë. I kanë marrë të kaluarën, do t'i marrin edhe në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Paraprakisht kisha dashur një sqarim, nëse eventualisht e përdor emrin e inicueses së debatit, nuk kam asnjë qëllim personal, mirëpo kjo është në kontest të fjalës. Do ta përmend se e kam në fjalim, se siç shihet kur është në pyetje interesi i tyre, po dinë edhe të reagojnë. Paraprakisht, para fjalës, kisha dashur t'ia sqaroj edhe zonjës Hykmete se aq mirë i shikoni kur janë në pyetje anëtarët apo thjesht ndonjë simpatizues i Partisë Demokratike të Kosovës, ndërsa nuk i shikoni anëtarët tuaj kur janë edhe në grupe. Edhe sot janë legjitimë anëtarët e Komisionit të Pavarur të Medieve, nuk reagoni kur e dini që e kanë thyer ligjin edhe bashkë me konkurrencë, me aplikim e kanë thyer ligjin. Pse nuk reagoni zonjë, reago! Po, do të reagojmë sigurisht.

Në këtë Kuvend, të nderuar kolegë deputetë, kam hyrë si pjesë e kësaj legjislature, jo pse rastësisht apo nuk e kam pasur fatin që ta kem germën A, siç e ka kolegja ime parashtruese e debatit, por me germën XH, krejt në fund të alfabetit, dhe kam hyrë dhe jam deputete e këtij Kuvendi duke i njohur votuesit e mi, duke i ditur edhe adresat e tyre, dhe paraprakisht në këtë drejtim ndihem shumë komode dhe flas me kompetencë, duke u thirrur në këtë debat, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah kinse shpërdorimin e mjeteve të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Unë, pra Xhevahire Izmaku, ndryshe nga kërkuesja e këtij debati, i njoh votuesit e mi, i njoh vuajtjet e bashkëqytetarëve të mi para lufte e në luftë, edhe dhimbjet e tyre, pranë djemve e familjarëve të vrarë. Andaj, do të më dhimbsej natyrshëm dhjetëfish më shumë çdo devijim nga synimi real dhe këtë e them me bindje se votuesit e mi, që kanë adresë, e dinë këtë fakt.

Duke mos pasur asgjë personale me zonjën Lama, për gjithë këtë zhurmë që e bën çdo herë në Kuvend, kisha dashur që ajo bile një herë të mos e shpërdorë ulësen e Kuvendit. Mirëpo, nëse për dy vjet me radhë sheh vetëm zi, kisha dashur të shoh një herë edhe bardhë. Pra, aq më keq kur të dhënat mbi të cilat thirret për ta iniciuar debatin janë të dhënat e një gazete dhe janë fakte, të cilat nuk qëndrojnë. Ne jemi Republikë e Kosovës, me 2 milionë banorë, ndihemi si një vend me ekonomi e ndërmarrësi jo shumë të zhvilluar dhe ato kompani, të cilat i apostrofon zonja Lama, posaçërisht po thirrrem në qytetin tim, që e njoh, se nuk është Shangai, janë kompani të cilat i kemi pasur në bashkëpronësi për të financuar. Prandaj, nuk është keq as “Vetëvendosja” në këtë drejtim, se ka marrë donacione.

Më ka ardhur shumë e çuditshme kur e kam parë se në çka thirret. Në thirrjen e debatit, zonja Lama e përdor edhe një fakt, duke u thirrur në emrin apo fushatën e iniciuar të Shaip Mujës, kolegut tim. Secili deputetë, edhe me ligj, ka të drejtë ta financojë fushatën e vet. Po çfarë ka pasur ta përmendë bashkëshorten e deputetit Muja. Doktoresha Anita ta braktisë profesionin pse burri i saj është deputet?! Kjo më është dukur shumë e pakuptimtë! Për çfarë arsyeje e ka përmendur?!

Pra, Ligji për financimin e subjekteve politike, konkretisht në nenin 5, thotë: “Subjektet politike lejohen të marrin kontribute nga: 1.1. Personat fizikë në vlerë prej jo më shumë se 2 000 euro, personat juridikë në vlerë jo më shumë se 10 000 euro. Pra doktor Shaip Muja ka financuar fushatën e vet dhe nuk është dashtë absolutisht që të përdoret si fakt në këtë thirrje debati.

Ju rikujtoj zonja Lama, se vendi ynë, Republika ime dhe jotja, e çdo qytetari të Kosovës, nuk zhvillohet duke bërë pyetje të thata. Më mirë të shihet një vepër se 1 000 fjalë tona, andaj veprat do të mbeten dhe këto vepra ne mund t’i shohim çdo ditë. Edhe ju mund t’i shihni, edhe mund t’i pyetni fëmijët, edhe të afërmit, edhe fqinjët tuaj, si kanë jetuar, si kanë shëtitur cep më cep Kosovës para se të vinte kryeministri Thaçi në pushtet dhe si është tani.

Unë vetëm do ta përmendi komunën prej nga vij, pasi e njoh. Deri në momentin kur Qeveria Thaçi nuk ishte në pushtet, komuna ime me 68 fshatra, me mbi 70 mijë banorë, i ka pasur vetëm 2 rrugë të shtruara. Sot i ka mbi 250 kilometra rrugë dhe qytetarët thjesht janë hequr nga balta. Ata fëmijë shkojnë në shkollë të reja, qytetarët kanë mundësi të shkojnë të shërohen në ambulancë të reja.

Mësimdhënësit janë të trajtuar thjesht më dinjitetshëm me rrogat e rritura. Pra, këto nuk janë rroga dhe mjete të kryeministrit Thaçi, por politikë e tij e sollën këtë rritje.

Ju kisha lutur, mënyra më e mirë për t’i dorëzuar pretendimet tuaja politike, të thata e boshe për të kundërtën e saj çka pretendoni jeni vetë ju, është për çdo ditë kur udhëtoni dhe i shihni këto vepra, e këtë mundësi e ka edhe kolegja ime e respektuar, Alma Lama.

Keni pasur mundësi të shihni se Kosova dhe lidhshipi i saj edhe në arenën ndërkombëtare në vitet e fundit kanë qenë pjesë e agjendave më kulmore të skenës ndërkombëtare, si në OKB, në FMN, në Bankën Botërore, pa përfshirë këtu njohjet e vazhdueshme që vijnë edhe nga shtetet anëtare të OKB-së.

Imazhi ndërkombëtar dhe subjektiviteti i saj në skenën ndërkombëtare është duke e zënë vendin e saj meritë në të gjitha forumet rajonale, evropiane dhe botërore.

Po e përfundoj, duke ju lutur që e vërteta dhe zhvillimi i Kosovës nuk përcaktohen nga fjalimet boshe e të paargumentuara, sidomos kur ato bazohen në copëza të gazetave, pa kurrfarë përmbajtjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Alma Lama, replikë.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Natyrisht që unë nuk do të bie në nivelin “intelektual” të koleges, sepse do të ishte fyerje për inteligjencën time. Por, mund të them vetëm që deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës po dështojnë tërësisht të bëjnë avokatin e dokumentit investigativ të qendrës hulumtuese. Nuk ka debat, që është thirrur në këtë Kuvend, më të argumentuar me fakte, me shifra. Të gjitha ato të dhëna madje janë nxjerrë nga institucionet e Kosovës, nga

institucionet zyrtare. Është OSHP-ja, është Auditori i Përgjithshëm dhe është KQZ-ja. Me pak fjalë ju kanë mbërthyer në mënyrë institucionale, edhe pse ju i kontrolloni këto institucione. Këta në mënyrë të vazhdueshme na akuzojnë faktikisht që po bëjmë zhurmë. Pse? Sepse e kërkojnë heshtjen tonë. Këta janë shumë të çuditshëm! Edhe vjedhin, edhe zhvatin bizneset, edhe e marrin pushtetin, herë me dhunë, herë me shantazhe, dhe në fund thonë - “Ju mos flitni!”. Po prit tani, edhe të drejtën e fjalës doni të na hiqni. Nuk besoj se do të jetë e mundur kjo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Edhe për thonjëzat mund t’i heqësh, se nuk e kam problem nëse i heq thonjëzat, zonja Lama, mirëpo nuk di cilës zonjë t’i besoj, cilës Alma. Asaj që vitin e kaluar në këtë kohë doli edhe e kundërshtoi vetë subjektin e vet? Pra, në këtë drejtim ndihem shumë komode se qëndroj dhe i besoj konceptit të partisë të cilën e përfaqësoj. Ndërsa ju, zonjë e nderuar, akoma nuk e kishit as një vit mandat dhe dolët e akuzuat për jotransparencë, për jodemokraci subjektin tënd. Tash, kujt t’i besoj, cilit koncept tëndit?

KRYESUESI: Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Po më dhimbset zonja në fjalë për mungesën e argumenteve për të folur. Në rast se unë kundërshtoj, jap vërejtje, jap mendimin tim, do të thotë që unë e kam guximin intelektual, e ju që rrini e heshtni nuk e keni atë, nuk e keni pasur kurrë dhe si duket as nuk do ta keni. Faleminderit!

KRYESUESI: Besoj që mbaroi kjo replikë. Atëherë fjalën e ka fjalën Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuari zoti nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Dhe i nderuari i vetmi ministër i pranishëm,

Unë do të përpiqem që ta kemi një qasje pak më ndryshe dhe nuk do të ndalem shumë në gjithë ato çka u thanë pak më herët. Unë besoj që institucionet e Kosovës, sidomos institucionet dhe agjencitë buxhetore, të cilat shpenzojnë mjete buxhetore, duhet njëherë edhe përgjithmonë të disiplinohen, të dinë ta bëjnë një planifikim ashtu siç duhet dhe paraja publike të harxhohet ashtu siç duhet.

Unë besoj që në këtë legjislaturë, por edhe në qeveritë e mëhershme, pasi e dimë që një buxhet është përcaktuar edhe nga Këshilli Ekonomik Fiskal, kur Kuvendi i Kosovës nuk ka pasur ndonjë peshë të madhe, dhe kur shpeshherë nuk kemi marrë gjatë atij mandati as raporte, nuk kemi pasur mundësi edhe të diskutojmë. Është mirë që tani po diskutohet, por është mirë që të gjitha këto kritika pozitive të zbatohen dhe kështu të krijohet një sistem që agjencitë buxhetore t’i menaxhojnë mjetet buxhetore dhe taksapaguesve kosovar t’u kthehen në mënyrë të drejtë.

Edhe qeveritë e mëhershme e kanë pasur një suficit buxhetor, bile një suficit shumë të madh buxhetor. Unë besoj që edhe ai suficit buxhetor tregon paaftësi të menaxhimit si duhet të parasë publike.

Më vonë kemi agjenci buxhetore, por edhe qeveri, të cilat po i harxhojnë mjetet ndoshta në 2-3 muajt e fundit, që tregon se nuk është një planifikim i mirë. Është mirë që të krijohet një menaxhim i mirë që agjencitë buxhetore në mënyrë shumë efikënte të bëjnë harxhimin e mjeteve financiare.

Unë do t'i marr vetëm disa shembuj shumë të vonshëm. Këshilli Konsultativ i Komuniteteve para një jave ka shkuar në Stamboll që të marrë këshilla për zgjidhjen e problemeve të komuniteteve dhe besoni që në Komisionin për Komunitete kemi aq shumë telashe për zgjidhjen e problemit të komunitetit rom në veri për shkak të ekspozimit me plumb, sepse është një Raport i Këshillit Evropian, ndërsa Këshilli Konsultativ për Komunitete shkon ta shohë Stambollin, thua se duan ta zgjedhin problemin e kurdëve në Turqi, e jo të komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Ata, nëse dëshirojnë, mund të vijnë në Komisionin e Komuniteteve që t'u tregojmë ku është problemi. Bile së paku kanë mund ta ndërtojnë një shtëpi dhe të hiqet një familje nga ai pozicion. Këtu është problemi, duhet të dimë ku t'i menaxhojmë këto mjete.

Ose, ta marrim një shembull tjetër. Parku i Bizneseve në Drenas është duke u ndërtuar tani plot katër qeveri dhe sa herë që shkoj për Pejë, e shoh ashtu të çaraveshur. Dhe, besoni, se investitorët e huaj, që dëshirojnë të investojnë, a thua ku duhet të investojnë? A thua ai park është pasqyrë e investitorëve që duhet të vijnë në Kosovë? Unë besoj që duhet të investojnë me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, nga të cilat do të ketë të hyra më të mëdha buxhetore.

Unë dua të them që duhet të disiplinohemi në shfrytëzimin më të mirë të mjeteve. Nuk e fajësoj ministrin e Financave. Ministri i Financave e ka bërë ndarjen e parave, të tjerët i harxhojnë, por agjencitë buxhetore duhet të disiplinohen dhe duhet të dinë t'i harxhojnë paratë.

Një problem tjetër që do ta kisha theksuar është që edhe delegacionet, nuk po dua të paragjykoj a duhet të shkojnë jashtë vendit, apo në numër më të madh, por nuk duhet të themi edhe para opinionit se jemi duke harxhuar shumë mjete financiare. Unë do ta marr veç një shembull, kur kam qenë me zonjën Myzejene Selmani, në një takim në Zagreb dhe delegacione tjera të Bosnjës, Serbisë kanë qenë rreth CEFTA-s, besoni që kemi qenë delegacioni me mjete shumë të pakta, derisa delegacioni serb ka shkuar me mjete shumë të sofistikuar, me mercedesë para Kuvendit, kurse ne me tramvaj. Dhe, besoni që Komisioni ynë nuk ka pasur para të qëndrojmë në hotel se ka qenë shumë i shtrenjtë, por është dashur diku thua se jemi në stacionin e trenit. Edhe ajo anë duhet të tregohet. Do të thotë, është një kohë dhe ka ardhur momenti që paraja publike duhet të menaxhohet ashtu si duhet dhe të krijohet një sistem. Ne të gjithë jemi njerëz dhe qenie organike që e lakmojmë paranë, dikush më shumë e dikush më pak, por duhet të krijohet një sistem i tillë që të mos mund të keqpërdoren dhe derisa të krijohet një sistem i tillë nëpër agjenci buxhetore me siguri do të ketë keqmenaxhim të parasë publike.

Një problem tjetër që po theksohet rreth auditimeve është se shumë media, për çdo shkelje të auditorit janë duke thënë se tash çdokush duhet të shkojë në burg. Unë besoj që Auditori jep disa vërejtje që të përmirësohen dhe që të mos përsëriten gabimet. Dhe, nuk do të thotë që për çdo auditim që duhet njerëz të burgosen, por ato rekomandime të atij auditori a po i përfill agjencia buxhetore? A po i bën ato gabime me qëllim, apo pa qëllim? Dhe secila agjenci buxhetore duhet të ketë, se ka auditorë të brendshëm, dhe ata duhet të jenë sa më shumë të përforcuar dhe profesionalë, që të mos lejojnë që agjencitë buxhetore t'i keqmenaxhojnë mjetet financiare dhe fondet publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeverisës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Po qe se shtrohet pyetja se cilat janë veprimtaritë më profitabile në Kosovën e varfër të pasluftës, atëherë, pa fije dyshimi, përgjigjja më e saktë do të ishte: politika, krimi dhe biznesi.

Për dallim prej vendeve të botës demokratike, ku politika ndihmon dhe përkrah luftën kundër kriminalitetit, në Kosovë është e kundërta. Politika dhe kriminaliteti bashkëjetojnë mjaft mirë, duke e përkrahur dhe ndihmuar në momente të rëndësishme njëra-tjetrën dhe kështu duke kontribuar, jo vetëm që të mbijetojnë, por edhe të zhvillohen në përmasa të mëdha. Por, në Kosovë, bashkëjetesës së politikës dhe krimi i është bashkangjitur edhe një pjesë e konsiderueshme e bizneseve, dhe në këtë mënyrë kanë krijuar një simbiozë, apo më mirë thanë një simtriozë, e cila, për fat të keq të qytetarëve të Kosovës, jo vetëm që po zhvillohet dhe rritet në mënyrë permanente, por është bërë në përmasa gjigante, saqë nuk ka gjasa t'i kundërvihet, jo vetëm qytetari i rëndomtë kosovar, por as institucionet e rëndësishme shtetërore, siç janë Policia, Prokuroria e Shtetit, gjykatat, e aq më parë institucionet e tjera të llojit të agjencive kundër korrupsionit, apo kuorumet kundër korrupsionit, të krijuara nga Presidenca dhe shoqëria civile kosovare. Pra, thënë shkurt, kjo qenie në formë të simtriozës është rritur nëpër masa aq të mëdha, sa është immune, me një mekanizëm mbrojtës të jashtëzakonshëm, por edhe mjaft e rrezikshme, sepse, jo vetëm që e ka dëmtuar seriozisht ekonominë, edhe ashtu të varfër kosovare, mirëqenien e qytetarit kosovar, por e ka rrezikuar dhe dëmtuar seriozisht edhe shtetin e ri kosovar.

Për ekzistencën dhe mbijetesën e këtij trekëndëshi politikë-kriminalitet- biznes, secili prej këtyre përbërës ka detyra dhe e ka kontributin konkret. Kështu, kriminaliteti kryen punë më të rënda dhe themelore për ndërtimin e këtij trekëndëshi, sepse, duke qenë në shërbim të politikës, ndihmon në vjedhjen e votave, nëpërmjet të cilave edhe shumë persona të dyshimtë janë instaluar në politikën kosovare, disa prej të cilëve, siç është ritheksuar ditë më parë nga mediet dhe nga kryetari i këtij Kuvendi, madje gjenden edhe në këtë Kuvend të nderuar të vendit tonë.

Për ilustrim, do të theksoja se gjatë reformës zgjedhore shumë herë në grupe punuese është shtruar pyetja: Pse militanti partiak dhe qytetari i rëndomtë e keqpërdor procesin

zgjedhor dhe e vjedh votën për ndonjë subjekt politik? Kurse përgjigjja ka qenë: Duke e vjedhur votën, e kanë krijuar shumicën në Parlament. Shumica në Parlament e themelon Qeverinë, me gjithë kabinetin e saj ministror, kurse Qeveria menaxhon dhe e shpërndan buxhetin shtetëror të grumbulluar nga populli i varfër kosovar, i cili e ka vlerën prej diku mbi një miliard euro.

Kuptohet, në procesin zgjedhor, për sigurimin e fitores së partisë në pushtet, nuk e japin kontributin e vet vetëm vjedhësit dhe manipuluesit e votave, respektivisht kriminelët. Por, kontributdhënien e tyre në këtë fitore e kanë dhënë edhe bizneset e afërta me koalicionin qeverisës, disa prej të cilave udhëhiqen drejtpërdrejt nga politikanët kosovarë, apo janë në llogari të tyre, por të regjistruara në emër të familjarëve, miqve të tyre, ose janë biznese që udhëhiqen nga djemtë, vëllezërit, bashkëshortët, kushërinjtë apo familjarët dhe miqtë tjerë të tyre. Zakonisht bizneset kontribuojnë duke dhënë donacione, herë-herë në shuma shumë të larta, por që opinionit i paraqiten me shifra të rrejshme dhe vlera simbolike me numra tre deri katërshifrorë.

Është e logjikshme që krimi dhe biznesi nuk ua bëjnë këtë përkrahje politikanëve, siç thotë populli “për sy të zi”, e as për shkak të programeve politike dhe të dashurisë së madhe që e kanë për këto parti politike, por e bëjnë për interesa dhe profite konkrete.

Vërtet, kompensimi, madje herë-herë dhjetëra apo qindra fish më i lartë për kriminelë dhe biznesmenët përkrahës në procese zgjedhore vjen nga Qeveria, e ndërtuar mbi bazën e votës së vjedhur dhe të manipuluar, si ndaj bizneseve duke u dhënë tender të shumtë me vlera madje edhe milionëshe, duke i favorizuar në raport me bizneset tjera, por edhe duke i mbrojtur nga çfarëdo lloj hetimi dhe ndjekje penale, si dhe duke krijuar biznese fiktive për pasurim të politikanëve të caktuar dhe pastrim të parave.

Ndërsa kriminelët dhe vjedhësit e votave, politika i shpërblen, në radhë të parë, duke i futur në biznese të shumta dhe duke u ofruar tenderë të caktuar. Kështu, fatkeqësisht, sot në Kosovë veprojnë shumë firma dhe kompani private, pronarët dhe menaxherët e të cilave e kanë një të kaluar të dyshimtë, për të mos thënë kriminale, e të cilët opinionin kosovar i njeh për shkak të aferave të ndryshme në procesin e privatizimit dhe të tenderimit, në përgjithësi.

Po ashtu, politika i shpërblen kriminelët, respektivisht personat që me vjedhjen e votës i kanë sjellë ata në pushtet, duke e lejuar aktivitetin e tyre kriminal në shumë sfera të krimit të organizuar, si në kontrabandë me duhan, alkool, armë, derivate të naftës, pastaj në reketim, fajde, trafikim me narkotikë, prostitucion, e shumë e shumë veprimtari tjera kriminale dhe kështu bashkëpunimi dhe simtrioza e tyre sa vjen e forcohet, kurse organet që merren me luftimin e kriminalitetit, si Prokuroria, Policia dhe gjykatat ose dobësohen, ose, ç’është më e keqja - pjesa e caktuar e tyre bëhet pjesë e këtij krimi të organizuar shtetëror.

Andaj, me qëllim të luftimit të këtij trekëndëshi kriminal, të formuar ndërmjet politikës, biznesit dhe kriminalitetit, kërkoj, në radhë të parë nga organet e EULEX-it, por edhe nga Policia, Prokuroria dhe gjykatat vendore që ta hetojnë çdo person të dyshimtë, si dhe ta

ndëshkojnë çdo person për të cilin vërtetohet se e ka shkelur ligjin, për të ndihmuar që me votën e vjedhur persona të pandërgjegjshëm të zënë pozita të rëndësishme në politikën kosovare. Si dhe t'i ndëshkojnë personat, të cilët udhëheqin me institucionet kosovare e të cilët i kundërshtëpërblejnë në mënyrë të kundërligjshme bizneset dhe kriminelët që i kanë ndihmuar në proceset zgjedhore. Ju faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Se Kuvendi është vendi ku duhet të debatohet, pajtohem, por nuk pajtohem se është e udhës që debati në Kuvend të ulet në një nivel të atillë, ku do të flasim për ndërmarrjet individuale, pa i pasur as faktet, e as njohuritë e duhura rreth aktivitetit të tyre.

Në këtë mënyrë rrezikojmë që padrejtësisht ta dëmtojmë imazhin e atyre ndërmarrjeve, gjë e cila konsideroj se nuk është interes, as i pozitës, e as i opozitës.

Informatave të cilave po u referohet propozuesja e këtij debati rrodhi nga një hulumtim i një gazete, të quajtur "Priport" dhe nga raporti i Auditorit.

Sa i përket të parës, konsideroj që Kuvendi nuk është vendi adekuat ku duhet të analizohen artikujt e gazetave, pasi ne edhe nuk jemi kompetentë për ta vlerësuar vërtetësinë dhe objektivitetin e këtyre të dhënave.

Natyrisht, nëse ka bazë për hetim, ne i inkurajojmë organet e hetuesisë në vend që të merren me këto çështje.

Sa u përket gjetjeve të Auditorit, ne e kemi diskutuar në Kuvend dhe ia kemi dhënë opinionit edhe rekomandimet tona për raportin në fjalë.

Më tuje, në kërkesën për debat nga propozuesja thuhet: "Kompanitë që e kanë financuar PDK-në janë shpërblyer me tenderë". Në këtë kontekst, unë vetëm dua të ju përkujtoj që të njëjtat kompani, të cilave propozuesja e debatit u referohet si kompani që e kanë financuar PDK-në, kanë fituar tenderë edhe në komunat, të cilat qeverisen nga partitë e tjera politike.

Dhe, ajo që dua të them me këtë rast është që të mos ngutemi me keqinterpretime.

Një kompani që e ka financuar PDK-në, nuk do të thotë që ajo kompani duhet të privohet nga ofrimi i mundësive për ta ushtruar aktivitetin e saj.

Pikërisht këto mund edhe të jenë kompanitë më konkurruese në treg, gjë që dëshmohet nga fakti që këto kompani kanë arritur të fitojnë tenderë edhe në komunat, të cilat qeverisen nga partitë tjera.

Duke u bazuar në performansën e deritanishme të komunave në Kosovë, konsideroj që komunat që po udhëhiqen nga PDK-ja janë komunat me arritjet më të mëdha dhe këto po pasqyrohen qartë në përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës për qytetarët. Këtë po e thonë më së miri qytetarët e Republikës së Kosovës, në vazhdimësi, me votën e tyre.

Të nderuar kolegë,

Për të përfunduar, ju kisha lutur që të mos e mbushim agjendën e Kuvendit me diskutime e debate që kanë për qëllim vetëm promovimin e interesave të ngushta partiake, por të fokusohemi në çështje të cilat i takojnë Kuvendit e të mos merremi me fakte të pabazuara dhe informata të paverifikuara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Po lidhem me temën menjëherë. Debati që është thirrur, është mirë që është thirrur. Vërejtjet e deputetëve duhet të jenë- pse s'është thirrur më herët që të bisedohet për temën e tillë kur e dimë që të gjitha raportet e brendshme dhe ato të jashtme, po flasin për një korrupsion marramendës në Kosovë. Dhe kjo temë është dashur shumë më herët të shtrohet.

Tjetër gjë që duhet të jetë në dinjitetin e deputetit, është pavarësisht nga cili pozicion vjen, nuk ka nevojë për avokatizëm a për një përkrahje të dyshimtë, por ka nevojë për një dinjitet vërtet qytetar për të mbrojtur pikërisht interesin e atyre prej të cilëve e kanë marrë besimin. Dhe në këtë rast nëse flasim në emër të votuesve në Kosovë, atëherë duhet t'ua kthejmë përgjigjen atyre votuesve, sepse e tha dikush që Kosova është e vogël, por pikërisht pse është kështu ne edhe po e dimë krejt çka po ndodh në Kosovë dhe nuk po mbetet pa u zbuluar.

Dhe, çka duhet të ndodhë në Kosovë, më shumë se gati gjysma e Qeverisë është në hetime, është nëpër gjykata, është nëpër prokurori dhe nuk po u dashka të debatohet për këtë temë se po i penguaka dikujt. Kujt po i pengon?

Krejt ata që e mbrojnë këtë mënyrë, se nuk po u dashka të sulmohen ata që vjedhin dhe që grabitin paranë publike, e kanë gabim, sepse duhet vërtet çështja të jetë themelore ajo që është edhe duhet të shtrohet e duhet të ngritët zëri edhe më lart. Bile më e keqja është kur thuhet, s'ka pasur nevojë për këtë debat, ose nuk duhet të thirret debat, po pikërisht, atëherë, fjala e lirë për çka është? Është pikërisht për të debatuar dhe për t'i treguar opinionit se çka po ndodhë në Kosovë.

Nga 40 raporte të auditimit, vetëm një del i rregullt dhe nuk paska nevojë për debat, po ka nevojë për shumë debat madje, në mënyrë që gjërat të sqarohen, jo në pozicionet e ngushta politike, por në pozicionin e atij që ta ka dhënë besimin që të mbrosh interesin e tij, që të mbrosh atë taksë që e paguan ai, të mbrosh jetën e tij. Sepse, në fund të fundit,

jeta e këtyre qytetarëve po varet pikërisht nga buxheti i shtetit të Kosovës. E ardhmja e këtij vendi po varet nga ky buxhet dhe kushdo që e shkel këtë buxhet, kushdo që prek në këtë buxhet, duhet të dënohet, duhet të jetë para gjyqit. Dhe këtë duhet ne ta përkrahim dhe jo të thuhet, pse është thirrur debati?

Një element që dua ta përmend: Pse nuk është aprovuar deri tani Ligji për konfiskimin e pasurisë së paligjshme? Po pikërisht është lejuar që të ndodhin krejt këto pasurime të paligjshme në Kosovë, në mënyrë që një ditë të bëhet një prerje dhe të thuhet, amnistohen të gjithë ata që kanë bërë çka kanë dashur në Kosovë, dhe të bëhet një veprim, i cili është pikërisht i paligjshëm në mënyrën e tillë të veprimit.

Unë konsideroj se edhe titulli i ligjit është me sherr. Edhe ky që tani e kemi në përpunim, sepse mundëson që edhe më tutje të grabitet, mirëpo konsideroj që deputetët, komisionet e kanë për detyrë ta bëjnë vlerësimin real të projektligjit, t'i bëjnë ndryshimet thelbësore në këtë ligj në mënyrë që të mos ndodhin grabitje ose shpenzim i fondeve publike në mënyrë të paligjshme, ose në mënyrë abuzuese.

Edhe për fund po e them, kushdo që del në mbrojtje të atyre që fondet publike i grabisin ose i menaxhojnë keq, dine se nuk i përfaqësojnë qytetarët e Kosovës, nuk përfaqësojnë dinjitetin e Kosovës.

Nëse duam shtet, atëherë nuk ka nevojë as me lutje, as me balancime, por ka nevojë me ligj të bëhen të gjitha veprimet që më së shumti është e thirrur kjo Qeveri t'i bëjë, e që s'i ka bërë. Për atë, është gjysma e saj nëpër akuza të cilat janë ngritur e që vërtet drejtësia duhet ta thotë fjalën e vet, duke qenë e pandikuar politikisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Unë do të lexoj pjesë nga hulumtimi i "Priporter", në mënyrë që qytetarëve të Republikës së Kosovës, t'u bëhen ne dije me fakte se sa e sa shkelje e keqpërdorime janë bërë gjatë financimit të fushatës elektorale të PDK-së.

Ky hulumtim i "Priporter" mbi prokurimet publike nxjerr thjesht dhe pa ndonjë koment të dhëna mbi 100 milionët e shpërndarë nga partia e kryeministrit, për kompanitë që atij ia zgjatën dorën gjatë fushatave zgjedhore.

Nga dokumentet zyrtare, ky hulumtim ka gjetur se 43 subjekte të ndryshme, kryesisht kompani ndërtimore, që si biznese dhe persona fizikë financuan PDK-në, në dy fushatat e fundit elektorale, kanë përfituar mbi 100 milionë euro nga tenderët publikë. Sipas raportit të auditimit të financave të partive për fushatën e vitit 2009 dhe atij për fushatën e vitit 2010, shuma e donacioneve që këto 43 subjekte dhanë për PDK-në është pak më shumë se 280 mijë euro. Për 11 nga to, u shkel edhe ligji dhe u dëmtua buxheti për t'i shpërblyer. Kjo i bie që kompanitë kanë rritur të ardhurat e tyre nga pushteti përmbi 350 herë, në krahasim me atë që i dhanë donacion partisë në pushtet.

Pasi “Priporter” ka gjetur këto të dhëna, ka pritur për më shumë se dy javë për një koment nga PDK-ja dhe nga Zyra e Kryeministrit Hashim Thaçi, por asnjëra dhe as tjetra nuk janë prononcuar në lidhje me shpërblimin prej 100 milionë eurosh të financuesve të kësaj partie me anë të tenderëve publikë.

Por, kjo marrëdhënie, në një pjesë të konsiderueshme zhvillohet larg mundësisë së monitorimit me dokumentacione, sepse thjesht një pjesë e konsiderueshme e financave të partive nuk është e mundur të identifikohen. Këtu flitet vetëm për kompanitë për të cilat ka mbështetje me dokumente zyrtare se janë të përfshira në financimin e partisë në pushtet, por duhet pasur parasysh se një numër i madh i tenderëve publikë u jepet kompanive që janë të afërta me PDK-në, porse nuk kanë ndonjë bashkëpronësi formale apo nuk dalin as si financues të partive politike.

Al-Trade, pronë e Bajram Gashanit, është një kompani shumë e pranishme në tenderët publikë, pronari i së cilës është me origjinë nga qendër-peshimi i PDK-së, Drenasi.

Kjo kompani vetëm nga Ministria e Arsimit ka marrë 7 tenderë, me vlerë prej afro 9 milionë euro. Kjo kompani në konsorcium me Kompaninë ADA Konsalting Grup, pronë e zyrtarit të Shërbimit Informativ të Kosovës - SHIK, Avni Kastrati, ka marrë një tender prej 600 mijë eurosh nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Megjithëse, sipas auditorit gjeneral ishin shkelur kërkesat e donatorit, Ambasadës britanike, për procedura të veçanta të prokurimit, Ministria e Kthimit, ia ka vazhduar kontratën kësaj kompanie për projektin për ndërtimin e banesave për minoritete.

PDK-ja ka shpërblyer edhe të afërmit e gazetarëve që mbajtën anën e kësaj partie. Kompania Albes, nga Istogu, pronë e Hajredin Mavrajt, ka marrë nga 5,7 milionë euro vetëm nga MASHT-i, kur atë e udhëhiqte ish-ministri Enver Hoxhaj, tash kryediplomat i Kosovës.

Familjari i pronarit të kësaj kompanie, Muhamet Mavraj, e boton gazetën “Epoka e Re”, që është e afërt me PDK-në.

Kjo kompani, pos tenderëve në MASHT, ka marrë tenderë milionësh edhe nga institucionet tjera që udhëhiqen nga njerëzit e PDK-së, madje edhe duke ofertuar me çmime 1200% më të shtrenjta se ato në treg.

Në tenderin e Ministrisë së Administratës Publike, ndërtimi i ndërtesës së Prokurorisë së Qarkut në Pejë, përfaqësuesi i kompanisë Albes, në seancën e mbajtur në OSHP, në lidhje me problemet që dolën me këtë tender, e pranon publikisht se qëllimisht ka përdorur çmime 1200% më të shtrenjta se në treg.

Në po këtë seancë, përfaqësuesi i kësaj kompanie thotë se në të njëjtën, sipas tij, strategji e ka aplikuar edhe në mbi 100 projekte të tjera, por megjithatë është shpërblyer me kontratë.

“Priporter” ka bërë kërkesë zyrtare në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për të interpretuar lidhshmërinë e shpërblimit të Asbestit me këtë strategji, por ky institucion nuk ka pranuar ta interpretojë këtë çështje.

Afërsia me pushtet ka mundësuar edhe shfrytëzimin e institucioneve publike, që është RTK-ja, për t’i shpërblyer njerëzit e vet.

Shaip Muja, ish këshilltar i kryeministrit Hashim Thaçi, që për PDK-n ka dhënë donacion 1.000 euro, ka 50% të aksioneve në Ana-derm, kurse 50% të tjera i takojnë gruas së tij, Anita Muja. Ajo është edhe pronare në kompaninë tjetër private, Ana-Z, me anë të së cilës ka përfituar një kontratë nga fondet publike të RTK-së , por që këta të fundit nuk pranojnë ta bëjnë publike vlerën e saj.

Edhe vëllai i deputetit Muja, Fatmir Muja, nuk është lënë anash. Kompania Cikos, pronë e Fatmir Mujës, e cila sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, merret me riciklimin e mbeturinave dhe hedhurinave metalike, kishte fituar tenderin për shitjen e mbetjeve të metalit nga kjo korporatë, derisa me prokurimin e Korporatës Energjetike të Kosovës, po udhëhiqte Nijazi Thaçi, tash zëvendës drejtor i kësaj korporate dhe njëherësh edhe kushëri i kryeministrit Thaçi.

Kjo kompani tash është në pronësi të Fatmir Mujës, vëllait të deputetit Shaip Muja dhe numri kontaktues i kësaj kompanie është i njëjtë me kontaktin e kompanisë “Kosova Green Energy”, biznes i deputetit Shaip Muja, i cili nuk është deklaruar në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Shaip Muja, replikë.

SHAIP MUJA: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Ky debat nuk është ftuar rastësisht, është ftuar për t’u krijuar një perceptcion tek qytetarët falsifikat, i cili në emrin e mbrojtjes së të drejtave të vegjëlisë, kjo klasë e dështuar politike, me një opozitë anemike, nuk mund t’ia arrijë assesit qendrës.

E para, unë ju kisha sugjeruar t’i lexoni ligjet në fuqi, të cilat janë që t’u japin të drejta personave që kanë kompani.

E dyta, mund të konsultoheni me “Priporter” se mos janë edhe ata disa deputetë, një deputet këtu tha, kur isha unë ministër, më kërkonin lekë, ose kërkonin favore që mos shkruaja unë për ta.

Unë nuk do të jem viktimë e tillë që të nënshtrohem, ndërsa i propozoj “Vetëvendosjes” ta pyesë Shpend Ahmetin çka është dallimi mes ankandit dhe mes tenderit për riciklimin e mbeturinave? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë, të nderuar,

Ky debat, do të thotë, për keqpërdorimin e parasë publike nga ana e Qeverisë, padyshim se është një debat i njëanshëm edhe politik, po shihet qartë për faktin se ne si shoqëri jemi të vetëdijshëm që për një kohë shumë të shkurtër, për të mos thënë më pak se një dekadë, korrupsioni apo keqpërdorimi ka marrë përmasa shumë të mëdha dhe mjaft me pasoja negative për shoqërinë tonë. Dhe është padrejtë dhe e njëanshme të themi se vetëm në institucione apo konkretisht në Qeveri, bëhet keqpërdorimi i parasë, kur ne jemi dëshmitarë dhe mjaft koshientë se keqpërdorimi i parasë publike bëhet në të gjitha nivelet, në të gjitha institucionet dhe në të gjitha strukturat e shoqërisë kosovare.

Raportet e ndryshme, qoftë të progresit dhe raportet e bashkësisë ndërkombëtare, që e kanë klasifikuar Kosovën si një vend me shkallën më të lartë të keqpërdorimit dhe të korrupsionit, janë aq të vërteta dhe ne duhet të merremi me atë brengë, e cila vërtet na ka përfshirë të gjithëve.

Korrupsioni apo keqpërdorimi i parasë publike, është një kancer i cili në mënyrë mjaft të heshtur është duke e përfshirë shoqërinë kosovare, duke shkatërruar dhe denigruar çdo nivel të shoqërisë së Kosovës.

Korrupsioni, më mirë të them keqpërdorimi i parasë publike është duke ndodhur në çdo nivel. Jemi dëshmitarë në shumë drejtori , nivele komunale dhe nivele qendrore, në Postë-Telekomin e Kosovës, në KEK dhe çdo kund është duke ndodhur një dukuri e tillë e keqpërdorimit, prandaj, të themi se vetëm në Qeveri, atëherë do të jemi të njëanshëm.

Ne e kemi këtë problem dhe duhet të mendojmë mirë se si ta menaxhojmë këtë problem. Është për të ardhur keq se si drejtorë të drejtorive, qoftë të arsimit , qoftë të niveleve tjera, keqpërdorin pozitën e tyre për të punësuar mësimdhënës të rinj apo qoftë nevoja edhe për të kryer ndonjë praktikë të thjeshtë në nivelin arsimor. Korrupsioni apo keqpërdorimi e ka përfshirë edhe Universitetin e Prishtinës, me keqardhje mund të themi, jemi dëshmitarë se shumë profesorë abuzojnë me detyrat e tyre. Korrupsioni e ka përfshirë edhe shëndetësinë, kemi një krizë etike në nivelin shëndetësor në të gjitha nivelet e institucioneve shëndetësore. Prandaj, të themi se vetëm në Qeveri, atëherë do të jemi shumë të padrejtë.

Ne do të duhej të jemi shumë më koshientë, të jemi shumë më vigjilentë dhe të dalim me një propozim të mirëfilltë se çka të bëjmë si shoqëri që ta mposhtim këtë dukuri të tillë, apo më mirë të themi këtë kancer të shoqërisë, e cila është mjaft vështirë. Dhe duhet ta pranojmë një fakt, se shumë vende kanë kaluar me vite e dekada të tëra për ta mposhtur këtë dukuri dhe padyshim se edhe neve na duhet, mos me thënë vite, por edhe dekada që ta zhdukim këtë dukuri, prandaj është shumë vështirë të çrrënjaset korrupsioni, e korrupsioni apo më mirë të themi, zhdukja e korrupsionit e ka vetëm një adresë - kur në pozita udhëheqëse menaxhuese vijnë njerëz të ndershëm- besimtarë, se njëri kur s'i frikësohet zotit, nuk i frikësohet as pozitës dhe as pushtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën. Ju njoftoj se janë edhe katër diskutues. Mendoj që ta kryejmë, sepse nuk ka arsye që të bëjmë pushim tash.

ARMEND ZEMAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Ministra të pranishëm,

Kolegë deputetë,

Me të vërtetë ndoshta, tema e propozuar mundëson një debat më të gjerë nga ajo për çka jemi thirrur sot edhe nga ajo konkretisht çka është paraqitur nga deputetja e nderuar Alma Lama.

Por si do që të jetë, unë po e filloj me nenin 7 të një ligji që është votuar këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me shumicën e votave, ku thuhet - konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, kur gjatë ushtrimit të funksionit të tij zyrtari ose personi i afërt ka interes privat pasuror ose personal jo pasuror, të drejtpërdrejt ose të tërthortë, që ndikon ose mund të ndikojë në kryerjen në mënyrë të drejtë të funksionit publik, kur gjendet në situatë të shkeljes së mundshme të parimeve, të kufizimeve dhe ndalesave apo detyrimeve, sipas Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit.

Kolegë deputetë,

Justifikimi i nivelit të lartë të korrupsionit, i cili çdo ditë po faktohet, ndërsa tendenca e relativizimit për të barazuar të gjithë njësoj, është tendencë e ikjes nga përgjegjësia edhe e Qeverisë, edhe e Kuvendit, nga vetë ata që apostrofohen shpeshherë si keqpërdorues të parasë publike.

Përgjegjësia për shpenzimin e parasë publike, duhet të jemi shumë vigjilentë dhe të pranojmë, ka degraduar jo vetëm në procesin e tenderëve me qëllim të përfitimit material, por edhe në një nivel tjetër, edhe në shpenzimet e parasë së imtë dhe deri te puna jashtë orarit.

Pikërisht kjo gjendje e krijuar tregon se për politikanë të papërgjegjshëm, tenderët qeveritarë, por edhe ata komunalë janë shndërruar në privilegj dhe pasuri të paligjshme, ku tani edhe në Kabinetin qeveritar dhe në Kuvend, në dobi, na dalin në sipërfaqe tregtarë të shkathhtë në përfitimin e fondeve publike, por edhe të pasurisë publike.

Shkalla e varfërisë, të gjithë e dimë, është e lartë dhe tek te papunët dhe punëtorët me punë ditore. Edhe ndarja buxhetore reflekton edhe interesat e ndarjes së tenderëve. Për shembull Juniku, me 1,2 milion për investime kapitale, ndërsa Shtërpca me 3 milionë, ndërsa vetëm nga viti paraprak, janë bartur borxhet 2,5 milionë në investime kapitale. Kjo tregon interesimin e veçantë të personave të caktuar në keqpërdorimin e fondeve publike. Dhe të mos të flasim shembuj të tjerë, mes Kamenicës, Malishevës e tjerë.

Kolegë deputetë,

Imagjinoni kur në Universitetin Publik të Kosovës, në Universitetin e Prishtinës, për shkak të tendencës që dikujt t'i jepet një tender i caktuar është dëmtuar buxheti i Kosovës nga vlera e tenderit 100 mijë euro, janë paguar vite më vonë, rreth 700 mijë euro, në

dëmtim të buxhetit apo të taksës së qytetarëve, vetëm e vetëm për të përmbushur egon e dikujt, për përfitime kryekëput materiale.

Si mund të kemi besim në ministra të resorëve të caktuar, e thashë përgjegjësia duhet të jetë individuale, që menaxhojnë paratë publike përmes tenderëve apo investimeve kapitale, ku kemi ministra, zëvendësministra, deputetë, përpos që marrin pagë dhe privilegje të resorit që e udhëheqin, marrin edhe pension apo social nga buxheti i varfër i Kosovës apo nga jashtë, bile-bile disa edhe pension invalidor.

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale bile e ka tejkaluar, merr pension social edhe nga shteti serb, ndërsa kemi edhe ministra, shikoni në deklaratën e pasurisë, marrin edhe pension, kryetarë komunash, ministra, zëvendësministra marrin edhe pension, edhe pagën, të cilën e kanë për punën që e kryejnë.

Vjedhja në Dhomën e Dëshmime në Prishtinë e në Pejë, deklaratat për deputetë vrasës në Kuvendin e Kosovës tregon përgjegjësinë morale, administrative dhe politike të nivelit institucional se ku gjendemi.

Prandaj, ju e dini, që këtu kemi pasur haptas ministër që ka thënë që tenderin ia kam dhënë kushërit, këtu, në këtë foltore dhe atë me krenari dhe me mburrje.

Më shumë se 160 raste, janë dorëzuar në Prokurori nga Agjencia Kundër Korrupsion dhe retorikës së përsëritshme se dërgoni faktet në prokurori dhe gjyqësi, i ka dalë boja, kolegë deputetë dhe është ikje nga përgjegjësia, sepse nivelin e gjykatave dhe të Prokurorisë vendore, por edhe të asaj të EULEX-it, tashmë vetëm po e shohim dita-ditës se në cilin nivel të përgjegjësisë janë.

Si mund të besojmë në gjyqësinë, apo si kemi mund të besojmë dhe në të kaluarën, kur kryeprokurori i qarkut të Prishtinës, pa e dënuar apo pa e akuzuar asnjë njeri në korrupsion, vite më vonë po mandatohet nga Qeveria dhe votohet nga shumica parlamentare, që të shkojë në Agjencionin e Prokurimit Publik, ndërsa kemi tash, po e shihni, edhe avokatë të cilët kanë qenë në përgjegjësinë e gjyqtarit se sa me fanatizëm e mbrojnë krimin dhe korrupsionin?

Për fund, kolegë të nderuar deputetë, edhe qytetarë, pasi që po e kemi mundësinë t'ju drejtohem, është fakt dhe kjo s'mund të mohohet, se sot askush në Republikën e Kosovës, nuk mund të marrë, bile- bile as që të konkurrojnë për tenderë milionësh, nëse paraprakisht nuk ka lidhje me njerëz të Qeverisë apo të komunave. Kjo praktikë rrezikon dhe është burim i korrupsionit, i krimit dhe i moszhvillimit ekonomik të vendit. Ju faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Valbona Dibra e ka fjalën.

VALBONA DIBRA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,
Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po debatohet këtu që ne jemi kundër debatit për këtë temë, por më lejoni të ju rikujtoj se opozita, ju opozita ishit ata që e bojkotuat pikërisht këtë debat javën e kaluar.

Nëse ju të nderuar dëshironi të debatonini ashtu si zgjoheni në mëngjes, ne ju ftojmë për debat të arsyeshëm dhe të faktuar në interes të qytetarëve të Kosovës.

U përmend shumë këtu dhe po ashtu edhe nga zonja kryesuese, nga deputetja që e ka thirrur këtë seancë, gazeta “Priporter” dhe niset nga botimet në këtë gazetë. Më duhet patjetër t’iu kujtoj disa ngjarje të ngjashme që ndodhën në vendet në rajon.

Ishte një gazetë në Kroaci, e që botohej një herë në javë, si shtojcë e gazetës “Slobodna Dalmacia”, që nga viti 1993, si e ndarë nga redaksia e kësaj gazete dhe ajo quhej: “Feral Tribune”, një gazetë e satirës politike që dilte me karikaturat më të ndryshme të ndjerit Franjo Tugjmanit, shante dhe ofendonte pothuaj se çdo gjë në Kroaci. Bënte shaka e satirë me njerëzit që e bënë Kroacinë të pavarur. E shante të ndjerin Franjo Tugjman si udhëheqës dhe shtetin e Kroacisë. Kjo gazetë shitej në sheshin e Zagrebit, dhe titujt e saj lexoheshin me zë të lartë nga disa njerëz të paguar. Shitej në dorë, e jo në kioska.

Por, çka ndodhi? Kroacia, në vitin e ardhshëm bëhet anëtare e plotë e BE-së, ndërsa “Feral Tribune”, fatkeqësisht, për shkak të problemeve financiare, e dha botimin e saj të fundit më 15 qershor të vitit 2008.

Sa i përket raportit të auditimit, që i është referuar njëanshëm deputetja e kam lexuar me kujdes dhe kam vërejtur se asnjë subjekt politik nuk dallohet me të gjetura më të theksuara, por të gjitha pothuaj se i kanë të gjeturat e njëjta.

Për shembull, në të gjitha subjektet politike dhe iniciativat qytetare, pa përjashtim, donacionet dhe kontributet në të holla, janë pranuar nga një donator brenda ditës disa herë në vlerë më të madhe se 1000 euro, që është në kundërshtim me Rregulloren 2004, mbi shpëlarjen e parave, përkatësisht të ligjit numër 03/L-196, për parandalimin e shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit.

Po ashtu, u është referuar edhe raporteve të UNDP-së. Ne të gjithë bashkë ndjehemi me ata që gjenden në një pozitë më të vështirë financiare, por ta dini se Kosova është një shtet i ri, që ka dalë së pari nga një fazë e gjatë e sundimit serb në Kosovë dhe së dyti e shkatërruar deri në themel nga lufta e fundit.

Nuk ka qenë e rastësishme hedhja e punëtorëve shqiptarë nga fabrikat e atëhershme, nuk ka qenë e rastësishme bartja e makinave nga fabrikat kosovare për në Serbi. Të gjitha këto i kanë pasojat e veta negative në zhvillimin e mëvonshëm ekonomik të Kosovës, të gjitha këto janë vragë që kanë lënë pasoja të parikuperueshme.

Vetëm shkurt, më lejoni t’ju njoftoj që jemi në përfundim të fushatës zgjedhore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kemi të dhëna rreth financimit të zgjedhjeve në vendin më demokratik në botë dhe vendin që e ndihmoi Kosovën në mënyrë të

vazhdueshme. Fushata zgjedhore ka kushtuar gjithsej për të gjithë kandidatët, 855.8 milionë dollarë, prej tyre 432.2 milionë dollarë për demokratët e presidentit Obama dhe 421 milionë për republikanët e Romnit. Vetëm ta dini se janë më tepër se 249 milionë kontribuues me vlera më të mëdha se 2000 dollarë. Fushata zgjedhore financohet në të gjitha shtetet e botës, nga njerëzit, simpatizuesit e çdo partie, kjo është më se normale.

Edhe në Kosovë ka njerëz të cilët ia donë të mirën këtij shteti të ri dhe kontribuojnë në ndërtimin e shtetit, prandaj ju lutem, mos e dezinformoni qytetarin e Kosovës me këso lloj informatash të paragjykuara dhe të njëanshme, të mos i quaj kryekëput akuzuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Alma Lama, replikë.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Jo, unë vetëm desha t'ia kujtoj zonjës Dibra dhe të gjithë atyre që dëgjuan që gazeta së cilës ajo i referohet përfaqëson mendimin kritik dhe ka vënë një gur shumë të fuqishëm në themelin e demokracisë dhe në shembjen e asaj ngrehine që në radhë të parë ka qenë më e padrejtë për shqiptarët, e që quhet Jugosllavi. Faleminderit!

KRYESUESI: Një minutë replikë.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryesues,

Unë desha t'ia kujtoj zonjës Alma se ka kaluar koha e UDB-së, për aso lloj arrestimesh. Faleminderit!

KRYESUESI: Mirë që po i ditshi ju të gjitha këto si shërbime. Fjalën e ka Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Pasi që vij nga bota e medieve, do të lidhem me sulmet e shumta që iu bënë deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës për emisionet e tyre që i kanë pasur në mediumin publik dhe unë po e them, të nderuar kolegë deputetë, se presionet e opozitës kanë qenë shumë të shpeshta dhe fal këtyre presioneve shumë shpejt do të transmetohet një emision i ri në Televizionin Publik të Kosovës, për shkak se edhe opozita është e implikuar në këto presione dhe po vazhdon t'i bëjë presion edhe menaxhmentit të RTK-së, por edhe të gjithë drejtorëve dhe stafit të Televizionit Publik të Kosovës.

Do të dal te tema, ftesa për debat, bazuar në një raport gazetaresk, të pavarifikuar, duke mohuar kështu edhe raportet zyrtare për menaxhim të financave publike, të përpiluar në mënyrë të rregullt nga auditori gjeneral, e të miratuar në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike, është tentativë e një grupi të caktuar të deputetëve për të ulur debatin dhe për të bërë zhurmë për asgjë.

Po qe se fillojmë t'i trajtojmë me radhë këto raporte gazetareske, ne duhet të organizojmë debate për çdo ditë, sepse të nderuar kolegë deputetë dhe të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, ne për çdo ditë po përballemi me kritika të shumta. Deputetët i

quajnë vrasës, deputetët i quajnë hajna, deputetët i quajnë deputetë pa legjitimitet, dhe nëse ne duhet të diskutojmë, atëherë seancat e këtij Kuvendi duhet të përshkohen vetëm nga këto shkrime dhe komente gazetareske.

Është e pamoralshme, madje shumë e pamoralshme të përmenden emra të të afërmeve të kryeministrit, se gjoja ata janë aty me vendim të kryeministrit Thaçi. Një gjë e tillë është keqpërdorim i kësaj foltoreje në këtë Kuvend.

Për ata që janë të keqinformuar, Nijazi Thaçi, është punësuar në KEK në muajin gusht të vitit 2006, do të thotë në kohën kur kryeministri i asaj kohe ka ardhur nga opozita dhe nuk ka qenë zoti Thaçi.

Dhe, për ata që nuk i dinë, këto janë të dhëna zyrtare në ueb-faqen zyrtare të KRPP-së dhe nuk janë që po i shpik unë tani këtu.

Të nderuar kolegë deputetë,
Asnjëherë financat publike nuk kanë qenë të menaxhuara më mirë se prej vitit 2008, kur në pushtet ka ardhur Partia Demokratike e Kosovës.

Për sot kjo nuk është temë e debatit dhe siç edhe e ceku ministri Hamzaj, dhe po e përsëris, se temë e debatit të sotëm do të duhej të ishte debat parlamentar lidhur me shkrimin e botuar në një të përditshme tonën nga grupe të caktuara të interesit, të cilat qëllim të vetin të tyre e kanë përfitimin personal dhe ardhjen në pushtet. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja deputete, faleminderit! Para se t'ia jap fjalën diskutueses së fundit, deputetes Sala Berisha-Shala, i thërras të gjithë deputetët të vijnë në sallë. Edhe në mënyrë teknike, i thirrni. Fjalën e ka Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit!

I nderuari zoti nënkryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar dhe ju të pranishëm,
Së pari më lejoni të përgëzoj shumë sinqerisht kolegen e nderuar Alma për gatishmërinë dhe energjinë për të bërë nisma në Kuvend, qoftë debate apo diçka tjetër.

Kjo është një shans e mirë për të qenë në vendet e para në vlerësimet e KDI-së dhe ky është një rast i mirë që perceptimi se gratë janë vetëm dekor në Kuvend, do të zhdaravitet atë perceptim, me radhitjen e koleges sime në radhë të parë të këtyre vlerësimeve.

Të nderuar të pranishëm,
Alma Lama, nga Fushë-Kruja, deputete e “Vetëvendosjes”, ka kërkuar debat parlamentar, i cili debat ka qenë në rend dite javën e kaluar. Javën e kaluar, nuk u mbajt debati, diçka jo e zakonshme për Parlamentin e Kosovës dhe praktikat e tij. Iniciuesi i debatit e lëshoi seancën, pa asnjë arsytim.

Të nderuar deputetë,

Seanca e sotme, me të vetmen pikë të rendit të ditës, ishte paraparë të fillonte jo si zakonisht në orën 10:00, por një orë me vonësë. Pra, do të duhej të fillonte një orë më vonë se sa zakonisht dhe kjo nuk është rastësisht.

Megjithëkëtë, “Vetëvendosjes” nuk i mjaftoi një orë dhe u desh të bëhet prapë një lëshim, na u desh të presim më shumë se gjysmë ore ne të gjithë deputetët e grupeve tjera parlamentare, sepse kolegët tanë nga “Vetëvendosja” e kishin humbur rrugën dhe në vend që të jenë në Kuvend, kanë hyrë në oborr të Qeverisë.

Të nderuar të pranishëm,

Kolegët tanë nga “Vetëvendosja” kanë zgjedhur rrugën për të zhvilluar aktivitetin e tyre, në vend që të jenë në seancë me kohë dhe aty ku u ka besuar qytetari dhe votuesi i tyre. Besoj që edhe këta kishin dëshirë të ishin me kohë në seancë, por ligjet e fizikës e përcaktojnë se nuk mund të jesh fizikisht në dy vende, në të njëjtën kohë.

Kolegë deputetë të “Vetëvendosjes”, nuk mund të jenë në të njëjtën kohë edhe në rrugë edhe në institucion, përkatësisht në Kuvend. Andaj, zgjidhni, të nderuar, rrugën apo institucionin, që të debaton dhe t’i zgjidhni problemet, që ua adresojnë qytetarët. Nuk e keni zgjedhur alternativën e duhur për të ardhur në pushtet, edhe pse mbrëmë e pamë se keni filluar të hulumtoni edhe mënyra dhe alternativa tjera, duke deklaruar se jeni të gatshëm të hyni në parakoalicion me parti tjera, edhe pse deri dje, për ju të gjitha partitë janë të njëjta “me gjynahet e tyre”.

Dhe krejt në fund, e për të mos e zgjatur, vjen pyetja që duhet “Vetëvendosja”, para së gjithash, t’ia shtroj vetes, përderisa një kolegut tim deputet, tha se Ramiz Lladrovcin e përdori Qeveria e Kosovës, juve kush po ju përdor, të nderuar? Faleminderit!

KRYESUESI: Paraqitësi i kërkesës, e jep fjalën e fundit. Fjalën e ka Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Së pari po duhet ta përsëris edhe një herë sqarimin, për herën e kaluar, kemi kërkuar të shtyhet debati, sepse e donim Qeverinë përballë. Dhe sot, sërish nuk është Qeveria përballë, pra vetëm pjesë të saj, e kemi vetëm ministrin e Financave, këtu. Ky është njëri nga ata që do të duhej të ishte, por do të duhej të ishte edhe kryeministri dhe ministri Beqaj.

Më bëri përshtypje krahasimi me Franjo Tugjmanin dhe Kroacinë. Kjo, më detyroj të flas. Në raport me Kroacinë, as shtet-ndërtimi e as integrimi nuk është njëjtë si Kroacia.

Për sa i përket shtet-ndërtimit, Franjo Tugjmani e ka vendosur sovranitetin e vet, ne nuk po e vendosim sovranitetin tonë. Franjo Tugjmani do të ishte në veri, tash. Franjo Tugjmanit ndoshta nuk do t’i ndodhte ajo me policët që i ka ndodhur, qoftë në Merdar, që na i rrahën policët, qoftë nuk i kishte ndodhur me policët sikur që janë poshtëruar në kufi.

Dhe, në anën tjetër, Feral Tribune, prapë e ka kryer punën e vet, sepse Kroacia po shkon drejt Bashkimit Evropian, sepse shumë nga kriminelët e ndryshëm të përfshirë në afëra të

korupsionit janë vendosur në burg, duke e përfshirë edhe kryeministrin e Kroacisë, Sanader.

Pra, Kroacia po e bën, e bëri shtet-ndërtimin, Kroacia po e bën edhe integrimin, ne nuk po e bëjmë as shtet-ndërtimin dhe me politikën që jemi duke e bërë, nuk jemi duke shkuar as drejt integritit.

Për sa i përket vonesës të deputetëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, në Kuvend, është në rregull, dakord jam, jemi vonuar, keq u bë, por këtu është faji te policia apo te Ministria, që nuk e kupton qartë ligjin të cilin e ka përcaktuar ky Kuvend. Pra, qasjen në institucionet publike që ia mundëson deputetit dhe po të respektohej nga policia apo Ministria e Punëve të Brendshme ky ligj, ne do të mund të hynim me kohë në seancë. Një gjë e tillë nuk ndodhi.

Natyrisht, do të dëshironim në përputhje me këtë ligj të merrnim vesh çka ndodh në Qeveri, sepse ligji na e mundëson një gjë të tillë, të mund të hyjmë në institucione të Qeverisë, t’i shohim se çka bëhet, qysh shiten, çfarë kontratash kanë, këtë na e mundëson ky ligj, por as atë nuk e zbaton, pra Ministria e Rendit, madje jep urdhër që të jenë të dhunshëm ndaj nesh.

Sa u përket politikave tona, sa i përket rrugës çfarë ne e zgjedhim dhe kombinimet që ia bëjmë ne me mjete jashtë institucionale dhe institucionale, ajo është pikërisht metodë jonë. Unë e di që po ju dhemb, por ne nuk do të heqim dorë prej saj.

KRYESUESI: Paraqitësja e kërkesës për debat. Fjalën e ka Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Më vjen keq të konstatoj që pozita pati shterpësi argumentesh në lidhje me këtë debat.

Më vjen gjithashtu keq që Partia Demokratike e Kosovës, për ta përballuar këtë debat, në frontin e parë ka nxjerrë gratë deputete, të cilat unë besoj që janë shumë më pak të korruptuara se sa ata tjerët, por nuk e kuptoj pse e kanë marrë këtë rol.

Qeveria, gjithsesi, materialin të cilin e ka pasur çdo deputet në dorë, ka pasur rastin ta përgënjeshtrojë, mirëpo nuk e ka bërë.

Më duhet t’i referohem fjalës së ministrit, i cili e hoqi barrën nga vetja edhe në lidhje me ndërmarrjet publike.

Në ndërmarrjet publike 100% aksionar është Qeveria. Gjithsesi, Qeveria thashë dështoi ta bëjë avokaturën e 100 milionëve.

(Reagim nga salla)

Është e drejtë e imja të flas tani.

KRYESUESI: Pesë minuta i keni, kryeji, se pastaj s'ke çfarë lexon. Vendors!

ALMA LAMA: Sot, shteti i Kosovës është shtet i zaptuar, ju vazhdoni t'i bini lodrave, por shteti është i zaptuar nga krimi dhe korrupsioni. Mos të harrojmë se shtetet që sot cilësohen të dështuara, e kam fjalën për atë listë të shteteve të dështuara, vuajnë pikërisht nga këto dy sëmundje, ose dy fenomene shumë negative. E kam hallin se çfarë do të thonë ata që pretendojnë që e kanë shpallur shtetin e Kosovës dhe kujt do t'ia hedhin fajin nëse ky shtet do të cilësohet si i dështuar.

Ne kemi kërkuar shtyrje të debatit herën tjetër, sepse donim që kryeministri të ishte prezent. Mirëpo, edhe kryeministri edhe ministri po i ikin debateve edhe në Kuvend, por edhe në media. Gjithsesi nuk do të mund t'i ikin ballafaqimit përfundimtar, që do të jenë zgjedhjet e ardhshme, por këtu po flas për zgjedhje, jo për vjedhje.

Kuvendi i Kosovës si organi mbikëqyrës i punës së Qeverisë ka përgjegjësi të madhe dhe duhet të luajë rolin për të cilin është mandatar, duke kërkuar llogari nga ekzekutivi për mënyrën e shpenzimit të parasë publike, prandaj unë si paraqitëse e këtij debati kërkoj, si më poshtë.

- Të kërkohej nga auditori i përgjithshëm t'i auditojë këta tenderë në mënyrë të detajuar;
- Të kërkohej nga organi shqyrtues i prokurimit raport në lidhje me rastet ku auditori ka konstatuar shkelje në tenderët e mëposhtëm;
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të iniciojë procedura ndëshkimore për subjektet politike të cilat nuk raportojnë në mënyrë të rregullt; dhe
- Brenda 6 muajsh Kuvendi të krijojë bazën ligjore, e cila rregullon kontrollin financiar të partive politike, auditimi i pavarur, i besueshëm dhe transparent. Ligji përkatës duhet të përcaktojë edhe trupin, pra institucionin që duhet të jetë bartës i këtij procesi.

Të nderuar deputetë, unë ju ftoj që t'i votoni këto pika të mocionit, sepse kjo është në shërbim të demokracisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Sa deputetë i kemi? Kolegë të nderuar, debati përfundoi. Në sallë i kemi 70 deputetë, bëhuni gati t'i votoni rekomandimet që i paraqiti zonja Lama, në emër të "Vetëvendosjes". Votojmë tash!

Konstatohet që me 35 vota kundër, 28 për, nuk janë miratuar këto rekomandime.

Mirë u pafshim në mbledhjet tjera!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë